Një peisazh malor, dominon në territorin e Komunës së Prishtinës, që përfshin lindjen, verilindjen dhe juglindjen, ndërsa ai perëndimor i komunës shtrihet në rrafshin e Kosovës. Ujërat që e karakterizojnë këtë rajon janë: Liqeni i Badovcit, Lumi Llap, Prishtevka, dhe Vellusha – pa lënë anash edhe Liqenin e Badovcit, pyjet, mineralet dhe tokat bujqësore që duhet të konsiderohen si burime natyrore me potencial për zhvillim. Marr në përgjithësi, natyra dhe mjedisi në zonat rurale të Kosovës, por edhe në Prishtinë, vlerësohen më të mira se sa ato në zonën urbane.

Por edhe në zonat rurale, sistemi i menaxhimit të mjedisit si uji, ajri, toka, mbeturinat dhe përgjithësisht kujdesi për natyrën, ka nevojë të përmirësohet duke përcjellur përvojat evropiane.¹⁶⁰ Qasja akoma e ultë në kanalizime, rreth 66 %, furnizimi me ujë të pijshëm sanitar, rreth 88%, ujërat urbane, rurale e industriale pa trajtim adekuat, menaxhim i kufizuar i mbeturinave, ndotja enorme e ajrit ,zhurma e lartë, antena të telefonisë mobile, kujdes jo i duhur ndaj gjelbërimit në qendër të qytetit dhe mungesa e vendeve për pushim e rekreacion, janë indikator kyç që alarmojnë për veprime të ngutshme në financim dhe përmirësim të performancës mjedisore.¹⁶¹ Qytetin e Prishtinës e karakterizon një trafik mjaft i dendur, me numër të madh makinash, qe brenda ditës qarkullojnë edhe nga shumë lokacione të Kosovës, me vende jo të mjaftueshme për parkim dhe makina të vjetra, që drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen e ajrit dhe në shëndetin e popullatës.¹⁶²

Aplikimi i burimeve alternative të energjisë po shënon rritje të ngadaltë. Instalimi i paneleve solare në disa ndërtesa të qytetit, QKUK-së është shembull nismëtar ku duhet përqendruar iniciativa tjera për të zbutur sadopak furnizimin e vështirësuar me energji elektrike dhe rritjen e efikasitetit energjetik dhe duke përmirësuar situatën mjedisore.¹⁶³ Gjendja e Termocentraleve A dhe B paraqet rrezikun më të madh për ndotjen e mjedisit të Komunës së Prishtinës, edhe pse këto termocentrale nuk ndodhen në territorin e saj. Duke u bazuar në të dhënat meteorologjike të marra nga Instituti Hidrometeorologjik në Prishtinë, era dominuese është ajo që fryn nga drejtimi veriperëndim-juglindje. Për këtë arsye shpërndarja e ndotjes bëhet 90% në drejtim të verilindjes dhe jo drejtpërdrejt në qytetin e Prishtinës.¹⁶⁴

Mosmbulueshmëria e plotë me ngrohje qendrore shton përdorimin e rrymës elektrike dhe druve për ngrohje, që e rëndojnë situatën mjedisore në qytet. Përdorimi i gazit natyral në amvisëri është i kufizuar. Trendi i ndërhyrjeve për përmirësim të izolimeve të objekteve ekzistuese pritet të japë efektet pozitive.¹⁶⁵

¹⁶⁰ Ibid.

¹⁶¹ Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2013-2023, 2013, p. 37.

¹⁶² Ibid.

¹⁶³ Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës 2012-2022, 2013, p. 37.

¹⁶⁴ Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2012-2022, 2013, p. 14.

¹⁶⁵ Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës 2012-2022, 2013, p. 37.

Mungesa e sipërfaqeve të gjelbëra dhe dominim i ndërtimeve të forta pa respektuar kriteret ngelin sfidë që vështirë mund të riparohen. Qyteti pa lumenjë, qofshin ata edhe të vegjël (Vellusha dhe Prishtina), po zhvillohet në aglomerat të thatë, me ndërtesa të shumta dhe planifikime të pakoordinuara me konceptin e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të popullatës. Për këtë moment gjendja në Prishtinë reflekton si jo në përputhje me parimet e Zhvillimit të qëndrueshëm: zhvillim ekonomik, përkujdesje sociale dhe ruajtje të mjedisit (shëndetit).¹⁶⁶

Problemet e identifikuara mjedisore sipas planit zhvillimor urban të Prishtinës janë: Zhvillimi ekonomik, i cili po shoqërohet me rritje të vazhdueshme të numrit të ndërmarrjeve prodhuese, si rrjedhojë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis. Varësisht prej veprimtarisë, ndikimi i operatorëve ekonomikë është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit, si në ajër, ujë dhe në tokë. Mungesa e filtrave në oxhaqet e operatorëve ekonomikë, lirimi i gazrave të ndryshme nga gjeneratorët, afërsia e termocentraleve, krejt këto ndikojnë në ndotjen e ajrit. Mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza komunale dhe industriale, ka ndikim në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Deponitë komunale, industriale, mbeturinat metalike dhe të automjeteve, si dhe shkarkimi i ujërave të zeza individuale dhe industriale, pa trajtim paraprak, janë burim i theksuar i ndotjes.¹⁶⁷

Ndikimi i problemeve mjedisore në Prishtinë nuk është përkthyer ende në efekte ekonomike apo shëndetësore. Për këtë arsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikëpamja sasimore shkalla e ndikimit që do të ketë plani mbi mjedisin apo shëndetin.¹⁶⁸

2.9.2 HAPËSIRAT PUBLIKE DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

Bazuar në informatat (raportet), nga zyrtarët kadastralë, hartat kadastrale, ortofoto dhe nga të dhënat e mbledhura në terren, shfrytëzimi i tokës në zonën urbane të Prishtinës është paraqitur në grafikun dhe hartën në vijim:

1. Sipërfaqja e ndërtuar-është 2365.6 ha ose 30.45% e sipërfaqes.
2. Zona e banimit -ka 2011.58 ha dhe karakterizohet me dominim të banimit individual;
3. Rreth 23.17% është banim individual (1800 ha) dhe 2.72 % është banim shumë-banesor (211.58 ha) pjesërisht me afarizëm;
4. Zona Ekonomike - zë një sipërfaqe 217.94 ha, ose 2.81% të sipërfaqes së ndërtuar, karakterizohet me dominim të industrisë;
5. Institucionet e arsimit - zënë një sipërfaqe prej 34.7 ha ose 0.45% të sipërfaqes së ndërtuar;

¹⁶⁶ Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2013-2023, 2013, p. 38.

¹⁶⁷ Ibid.


¹⁶⁸ Ibid., p. 67.

6. Institucionet shëndetësore - zënë sipërfaqe prej 33.9 ha ose 0.44% të sipërfaqes së ndërtuar;
7. Institucionet administrative zënë sipërfaqe prej 50.08 ha ose 0.64% të sipërfaqes së ndërtuar;
8. Objektet e kultit - zënë sipërfaqe prej 7.13 ha ose 0.10% të sipërfaqes së ndërtuar;
9. Sipërfaqet e gjelbra - zënë 5023.05 ha ose 64.06% të sipërfaqes;
10. Sipërfaqet specifike - 149.11 ha ose 1.92h% të sipërfaqes;
11. Sipërfaqet e transportit dhe trafikut - zënë sipërfaqe 231 ha ose 2.97 % të sipërfaqes.

Pronësia në zonën urbane të Prishtinës grupohet në:

- Pronësi shoqërore - 2695.21 ha ose 34.7%.
- Pronësi private - 5073.48 ha ose 65.3 %.
- Numri i përgjithshëm i ngastrave është 2,5524, prej të cilave 3,437 janë ngastra shoqërore, ndërsa 2,2087 janë ngastra private.¹⁶⁹

Figura 5. Harta e Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2012-2022



Burimi: Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës 2012-2022, 2013, p. 33.

¹⁶⁹ Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës 2012-2022, 2013, p. 70.

Prishtina ka hapësira të lira, por janë të pamjaftueshme për numrin e madh të shfrytëzuesve. Përveç Parkut Gërmia, Parkut të qytetit dhe disa sipërfaqeve të gjelbra, përfshirë parqet e vogla në lagjet e banimit kolektiv, sheshet para disa ndërtesave publike, dhe bulevardit “Nënë Tereza”, hapësirat tjera potenciale janë pjesërisht të zhvilluara.¹⁷⁰

Hapësirat ekzistuese të lira në Prishtinë nuk mjaftojnë, sidomos në zonat qendrore, të cilat shërbejnë si vendtubim me funksione tjera si:

- Hapësira publike si zonë e zhvillimit të veprimtarive ekonomike – tregti dhe shërbime;
- Hapësira publike si hapësirë e kulturës dhe ngjarjeve publike;
- Hapësira publike si hapësirë e rekreacionit;
- Hapësira publike si hapësirë reprezentative.¹⁷¹

Shndërrimi i bulevardit “Nënë Tereza” në Prishtinë në një shëtitore të lirë nga trafiku motorik, mund të konsiderohet sukses në kontekst të krijimit dhe ruajtjes së hapësirës publike. Qyteti ka përfituar shumë me këtë shesh në aspekt social, aspekt komunikimi të jomotorizuar pushimi, tregtisë, sikurse dhe organizimit të ngjarjeve të përditshme artistike, kulturore, kremteve të ndryshme.¹⁷²

Në aspektin mjedisor, po ashtu ky është një sukses i madh ku ndotja nga trafiku, tymi dhe zhurma gati janë eliminuar fare. Në aspektin ekonomik, jo vetëm që janë rritur të ardhurat e bizneseve në bulevard, por edhe vlera e banesave dhe e hapësirës afariste është rritur shumëfish.¹⁷³

2.9.3 CILËSIA E AJRIT

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë, realizohet nga institucionet shtetërore (HIK, NIPH, dhe INKOS) dhe nga operatorët ekonomikë që kanë impakt në cilësinë e ajrit. Mirëpo, rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë nuk është ende i plotë. Niveli i ndotjes së ajrit, siç raportohet edhe nga Komuna e Prishtinës, është kryesisht prezente në zonën urbane të qytetit dhe pjesërisht në atë rurale në drejtim të Obiliqit dhe Fushë-Kosovës, ndikuar nga prezenca e KEK.¹⁷⁴

Deri në vitin 2010, cilësia e ajrit në qytetin e Prishtinës, është vlerësuar vizuelisht, përmes shqisave të frymëmarrjes apo përmes disa matjeve të pakta të parametrave që duhet të monitorohen. Nga viti 2010, Prishtina ka një sistem relativisht të kënaqshëm të monitorimit të cilësisë së ajrit. Për nga numri i stacioneve

¹⁷⁰ Ibid.

¹⁷¹ Ibid.

¹⁷² Ibid.

¹⁷³ Ibid., p. 68.

¹⁷⁴ Ibid., p.15.

monitoruese, (4) Prishtina ka plotësuar një ndër kriteret për stacione të tilla, por jo edhe numrin e parametrave që kërkohen nga BE dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë. Tani monitorohen 5 parametra, ndërkohë që sipas standardeve, BE-ja kërkon matjen e së paku 12 parametrave, ndër të cilët edhe benzeni, metalet e rënda etj. Në Prishtinë, përmes dy stacioneve monitoruese, përcillen këta parametra: NO_x, SO₂, PM₁₀/PM_{2.5}, ozoni dhe CO. Kontribuuesit më të mëdhenj të ndotjes së ajrit, janë burimet statike dhe ato të lëvizshme.¹⁷⁵

Qyteti ndikohet kryesisht nga transporti i brendshëm dhe ai transit përgjatë magjistrave kryesore. Të gjitha rrugët janë të stërngarkuara me numër të madh të automjeteve nga të gjitha llojet, ndërsa kur përdoret karburant me cilësi jo të mire dhe makina të vjetruara nikimi në përkeqësim të cilësisë së ajrit vjen duke u shtuar. Ndotja e ajrit shumëfishohet e ndihmuar edhe nga amvisnitë. Ngrohja e qytetit konsiderohet ndër ndotësit më të mëdhenj për shkak të sasive të mëdha të mazutit që përdoret në kazantore gjatë sezonit të ngrohjes.¹⁷⁶

Në qytetin e Prishtinës, problem të veçantë paraqet prania e pluhurit, në formë të PM₁₀ dhe PM_{2,5}, vlerat e të cilëve parametra tejkalojnë Vlerat e Lejuara Maximale(VML), përderisa VML e lejuar është 40µg/m³. Vërehet se përqendrimi më i lartë i ndotjes së ajrit me PM₁₀ ka qenë gjatë muajve të sezonit dimëror.¹⁷⁷ Sa i përket klimës, është kontinentale, me një temperaturë vjetore mesatare prej 10,4 °C dhe me reshje vjetore mesatare prej 600 mm. Në korrik, temperatura mesatare vjetore arrin prej 30 °C, në janar prej -0,6 °C.¹⁷⁸

2.9.4 BURIMET UJORE DHE KLIMA

Dikur Prishtina kishte dy lumenjë: Prishtevkën dhe Vellushën, të cilat sot nuk janë përmbi sipërfaqe, duke u shndërruar në kolektorë të ujërave të zeza.

Prishtina kishte një plan për trajtimin e ujrave të zeza, me objekt të ndërtuar përkatës, sipas metodologjisë së viteve “50-ta”. Ky objekt i trajtimit mekaniko-kimik i ujrave të qyteti të Prishtinës, sikur na përkujton nevojën imediate të inicimit të planifikimit të ndërtimit të objektit gjegjësisht me metodologji dhe teknologji moderne, bazuar në kriteret për qëllime të tilla.¹⁷⁹

Qasja në ujë të pijshëm është e pjesshme. Problemi me ndotjen e ujit, është një çështje shqetësuese në tërë Kosovën, e sidomos në fshatra. Si pasojë e mungesës së infrastrukturës së përshtatshme, ndotja e ujit është problem edhe në lagjet e reja të paplanifikuara. Po ashtu, kanalizimet derdhen drejtpërdrejt nga vendbanimet në mjedis në ndonjë gropë, për të kaluar pastaj në ndonjë përroskë apo lumë, duke

¹⁷⁵ Ibid., p.38.

¹⁷⁶ Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2013-2023, 2013, p. 51.

¹⁷⁷ Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës 2012-2022, 2013, p. 39.

¹⁷⁸ Ibid., p. 40.

¹⁷⁹ Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2013-2023, 2013, p. 52.

shkaktuar kështu probleme të mëdha. Në disa fshatra, sistemet e kanalizimit janë ndërtuar nga vetë banorët dhe shpesh derdhen pa ndonjë mbikëqyrje dhe larg standardeve të dëshiruara. Ndotja e ujit shkon përtej vlerave maksimale të lejuara dhe disa lumenj si Prishtevka, janë transformuar në mbledhës të ujërave të ndotura.¹⁸⁰

Qyteti njihet që ka sasi të limituara të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të cilat kryesisht janë të shpërndara në pjesët periferike. Një pjesë e vogël e sasisë së ujërave gjenden si ujëra nëntokësore, psh në fushën e Pajtimit me sasi 50 l/sec dhe burimit të Gërmisë me sasi deri në 15 l/sec.¹⁸¹

Rrjedhat ujore janë të pakta, përderisa në pjesën urbane janë lumenjtë e vegjël: Prishtina, dhe Vellusha, që grumbullojnë edhe rrjedhat ujore të prockave nga Lagja e Spitalit, e Matit dhe nga pjesa veriore/ Kodra e trimave dhe Shkabaj. Lumenjtë Prishtina dhe Vellusha, në pjesën më të madhe të zonës urbane janë të mbuluar shërbejnë për grumbullimin e ujërave të shiut nga të gjitha pjesët urbane të Prishtinës. Burimet kryesore të ujit të pijes mbeten liqenet akumuluese të Batllavës dhe Badovcit.¹⁸²

Liqeni i Batllavës – Ka vëllim prej 38 milion m³ ujë dhe furnizon qytetin e Prishtinës me 65%. Ky liqë paraqet resursin kryesor të ujit të pijes për territorin e Komunës së Prishtinës, i ndërtuar në vitin 1960- 1963, fillimisht për furnizim me ujë teknik për kompleksin energjetik në Obiliq dhe më pas nga viti 1982 shëndrruar në resurs ujqor për ujë të pijes për regjionin e Prishtinës. Në Shajkovc (Alabnik) është e ndërtuar fabrika e përpunimit të ujit me kapacitet maksimal prej 900l/sec.¹⁸³

Liqeni i Badovcit – Ka vëllim prej 27 milion m³ dhe furnizon qytetin e Prishtinës me ujë me 35 %. I ndërtuar në vitin 1960 për furnizim me ujë të pijes ,ujitje dhe ujë teknik për minierën e Kishnicës. Nga viti 1980 ky liqen kryesisht përdoret për ujë të pijes për qytetin e Prishtinës dhe zonën periferike. Në Badovc është ndërtuar fabrika për përpunimin e ujit me kapacitet 400l/sec.¹⁸⁴

Burimet nëntokesore të Kolevicës dhe burimi i Gërmisë paraqesin resurset natyrore prej të cilave është furnizuar Qyteti i Prishtinës në vitet 1950-1970. Burimet e Kolevices kanë kapacitet prej 50 l/sec. Në vitin 1982, pas ndërtimit të sistemit të Batllaves dhe rritjes së ndotjes nuk janë më funksion, përderisa burimi i Gërmisë me kapacitet prej 15l/sec, përdoret si furnizuesi kryesor i pishinës së Gërmisë.¹⁸⁵

¹⁸⁰ Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2012-2022, 2013, p. 15.

¹⁸¹ Ibid.

¹⁸² Ibid.

¹⁸³ Ibid., p. 17.

¹⁸⁴ Ibid.

¹⁸⁵ Ibid.

Rezervuaret e ujit dhe Stacionet e Pompave - Prishtina ka konfiguracion të përshtatshëm për vendosjen e rezervarve. Qyteti i Prishtinës i ka 6 rezervoarë me vëllim total prej 70.000 m³ dhe janë të paraqitura si në tabelën e mëposhtme:

Rezervoaret janë të vendosura në pika kyçe që mbulojnë me furnizim zona të caktuara të qytetit të Prishtinës. Zonat e presionit shtrihen prej 550 m/nd deri në 720 m/nd . Rezervuaret në total kanë një vëllim prej 70.000 m³ dhe janë: Pjesë e furnizimit me ujë të pijes, janë edhe stacionet e pompave që janë në pjesët e ndryshme të Prishtinës. Stacionet kryesore të pompave janë: Rrjeti shpërndarës përbehet prej rrjetit primar dhe sekondar, ndërsa diametrat e rrjetit primarë janë nga Dn(80-1000) mm dhe rrjetit sekondar nga Dn(65-25)mm. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të ujit brenda zonës urbane është 450 km. Materialet janë: Azbest çimentoja, (A.C),PVC, Polietileni(PE) Hekuri daktil (DCI) dhe (CI) Gypat e zingruar(GI). Gypat datojnë nga vitet e 50-ta. Si pasojë e vjetërsisë ka dhe humbje relativisht të larta rreth 50% nga të cilat 35% janë humbje teknike dhe 15% humbje komerciale.¹⁸⁶

Menaxhimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijes dhe ujëra të zeza bëhet nga kompania publike "Ujësjellësi Rajonal Prishtina", e cila ofron shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në 8 Komuna. Me shërbime të ujit janë të kyqur rreth 97% të banorëve, ndërsa pjesa tjetër me furnizim individual nga e pusët. Pas vitit 1999 ishte sfidë furnizimi i rregullt me ujë të rregullt përmes sistemit të ujësjellësit, shkak u l mungesës së ujit dhe humbjeve të larta të ujit gjatë sistemit. Sot ekzistojnë reduktime të planifikuara të ujit të pijes ku ndërprerjet e ujit janë 8-10 orë mbrenda 24 h. Numri i konsumatorve që faturohen në zonën urbane llogaritet të jetë rreth 55.000. Sasia totale e ujit që Distribuohet për zonen urbane është 850 l/sec ndërsa konsumi për kokë banori është 140 litra/ditë/banorë.¹⁸⁷

Në aspektin klimatik Prishtina ndodhet në 42°39'49, 39' gj.gj.v., që nënkupton afërsisht në gjysmë të rrugës ekuator-pol. Nga kjo kuptohet se nuk ka as klimë të nxehtë sikur brezi ekuatorial e as klimë të ftohtë si brezi polar. Gjerësia gjeografike përcakton këndin e rënies së rrezeve të diellit, gjatësinë e ditës, pozitën në raport me celulat kryesore të ajrit. Në disa data të rëndësishme klimatike gjatë vitit këndi i rrezeve të diellit (lartësia e Diellit mbi horizont) që bie në Prishtinë është: në ditën e ekuinoksit pranveror e vjeshtor (21.III. dhe 23.IX.) 47°21', më 22.VI. (tropiku i Gaforrës) 70°48', ndërsa më 22.XII. (tropiku i Bricjapit) 23°54'.¹⁸⁸

Përveç gjerësisë gjeografike, faktorë të rëndësishëm klimatikë janë: Relie (lartësia mbidetare dhe ekspozicioni) largësia nga detet, pozita në raport me rrymimet lokale të ajrit etj. Vlera mesatare ditore e energjisë së rrezatimit të përgjithshëm është 4,32 kWh/m², me vlera më të larta gjatë verës dhe më të ulta gjatë stinës së dimrit. Vlera mesatare vjetore e energjisë së përgjithshme të rrezatimit diellor është relativisht e

¹⁸⁶ Ibid.

¹⁸⁷ Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2013-2023, 2013, p. 53.

¹⁸⁸ Ibid.

lartë dhe luhatet deri në 1.578 kWh/m². Vlera mesatare vjetore e zgjatjes së diellzimit është rreth 2.119 orë/vit. Vlerat mesatare mujore të diellzimit sillen nga 301 orë në muajin korrik, 290 orë në gusht, deri në 62 orë në dhjetor dhe 74 orë në janar.¹⁸⁹

Vlera maksimale të diellzimit gjatë vitit është 5.8 orë/ditë. Vlerat maksimale të diellzimit gjatë ditës paraqiten në muajt korrik (9.7 orë), gusht (9,4 orë), ndërsa vlerat minimale paraqiten gjatë muajve të dimrit, dhjetor (2 orë), janar (2,4 orë/ditë). Temperatura e ajrit është treguesi kryesor i motit që bën lëkundje të ndryshme gjatë ditëve, muajve dhe viteve. Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Prishtinë është 9,9°C. Muajt me temperaturën mesatare më të nxehtë janë korriku (19,8°C) dhe gushti (19,6°C), ndërsa muajt me temperaturën mesatare më të ulët janë janari (-1,4°C) dhe dhjetori (0,3°C). Gjatë stinës dimërore në Prishtinë janë disa ditë me temperatura mesatare ditore nën 0°C; në muajin nëntor është një ditë, në dhjetor janë 15 ditë, në muajin janar janë 20 ditë, kurse në muajin shkurt janë 5 ditë. Numri i ditëve është mesatar, sepse dallon nga viti në vit.¹⁹⁰

Shpeshherë temperatura minimale absolute ka arritur në vlera mjaft të ulëta. Dimra mjaft të ftohtë konsiderohen janari i vitit 1985 (13 janar), kurse temperatura minimale absolute ishte minus 27,2°C, pastaj dimrat viteve 1962/63, 1968/69, 1980/81, 2009/10, 2015/16, 2016/17, 2017/18 etj. Ekstremi tjetër i temperaturave maksimale absolute ka arritur deri në 37,3°C (31.7.1985) dhe 39,2°C (06.8.1988). Sa i përket stinëve të vitit, dimri është stina me temperaturën mesatare më të ulët (0°C), pastaj vjen pranvera (9,9°C) dhe vjeshta (10,5°C), kurse vera është stina më e nxehtë me temperaturë mesatare prej 19,1°C.¹⁹¹

Në aspektin klimatik me rëndësi janë ditët me ngrica, perkatësisht fillimi dhe mbarimi i tyre. Gjatë të kaluarës, sipas të dhënave klimatike, dita e parë me ngrica e paraqitur në Prishtinë është 17 shtatori, ndërsa dita e fundit është 19 maji. Në përgjithësi numri mesatar i ditëve me ngrica për Prishtinën është 101 ditë, që paraqet numrin më të madh nga të gjitha qendrat regjionale të Kosovës. Gjatë vitit në Prishtinë paraqiten 101 ditë me ngrica (temperatura minimale ≤ 0°C), 22 ditë me akull (temperatura maksimale ≤ 0°C), 10,9 ditë shumë të ftohta (temperatura minimale ≤ -10°C), 73,2 ditë verore (temperatura maksimale ≥ 25°C) dhe 16.1 ditë tropike (temperatura maksimale ditore ≥ 30°C). Ditët tropike janë karakteristike për stinën e verës ku, përveç temperaturës së lartë, ajri veçohet me lagështi të madhe, që e bënë frymëmarrjen më të vështirësuar. Sa i përket temperaturave të ulëta dhe kohës së paraqitjes gjatë vitit, vlenë të theksohet data 7 tetor 2017, kur temperaturat minimale iu afruan vlerës zero, madje u shoqëruan edhe me dëborë.¹⁹²

¹⁸⁹ Ibid.

¹⁹⁰ Vendbanimet e Kosovës, 2018, pp. 22.

¹⁹¹ Ibid.

¹⁹² Ibid.

Vlera mesatare e lagështisë së ajrit për qytetin e Prishtinës është 71,8%, me luhatje të vogël gjatë vitit. Prej fillimit të vitit (janar, 83,1%) lagështia e ajrit fillon të zbret me një ritëm të ngadaltë deri në muajin korrik (63,9%) dhe gusht (63,1%), për t'u ngritur vlera e saj në drejtim të pjesës së fundit të vitit, në nëntor (80,1%) dhe dhjetor (83,7%). Vlerat ekstreme të lagështisë së ajrit (<30%) janë regjistruar në muajin shtator (1961) dhe tetor (1971). Vranësirat luajnë rol të rëndësishëm në kushtet e motit të qytetit, por edhe në gjendjen emocionale të njerëzve. Të mbuluarit e qiellit me re është dukuri që ka ndryshime gjatë vitit. Mesatarisht gjatë vitit qielli mbi Prishtinën është i mbuluar me vranësira rreth 55%; ecuria vjetore ka lëkundje ndërmjet dhjetorit (73%) dhe gushtit (34%).¹⁹³

Në përgjithësi, mbulueshmërinë më të madhe me re e ka stina e dimrit, ndërsa më të vogël stina e verës. Numri i ditëve të kthjellëta në qytetin e Prishtinës sillet nga 2,9 ditë në janar, në 13,3 ditë në gusht, ndërsa mesatarja e ditëve të vranëta luhet nga 16,1 ditë në dhjetor, në 2,8 ditë në gusht. Në Prishtinë dhe në Rrafshin e Kosovës ekzistojnë kushte të favorshme për paraqitjen e mjegullës, që ndërlihet me morfologjinë e relievit, e rrethuar me male në periferi dhe e fuqizuar nga faktori njeri me termocentralet etj.). Mjegulla qëndron nga disa orë, deri në disa javë; periudha më e gjatë kohore e shënuar me mjegull në Prishtinë ishte gjatë gjysmës së dytë të dhjetorit të vitit 2013, deri në fund të gjysmës së parë të janarit 2014. Numri mesatar i ditëve me mjegull në Prishtinë është 29,8 ditë në vit. Numri më i madh i ditëve me mjegull paraqitet në nëntor (5 ditë), janar (5,9 ditë) dhe dhjetor (7,2 ditë), ndërsa numri më i vogël i ditëve me mjegull paraqitet në prill (0,3 ditë) dhe në korrik (0,6 ditë).¹⁹⁴

Reshjet konsiderohen element i rëndësishëm klimatik, me ndryshime horizontale dhe vertikale. Sasia mesatare e reshjeve për qytetin e Prishtinës është 599 mm, që paraqet njërin nga lokacionet me më së paku reshje në Kosovë. Reshjet në Prishtinë kanë dy maksimume: maksimumi i parë që paraqitet në maj (68 mm) dhe maksimumi i dytë në nëntor (68 mm). Po ashtu, reshjet kanë dy minimume: i pari paraqitet në muajin shkurt (36 mm), ndërsa i dyti në shtator (42 mm).¹⁹⁵ Sasia e reshjeve ka pasur ndryshime nga viti në vit. Vlenë të theksohen disa vite karakteristike në të cilat sasia e reshjeve ishte krejtësisht ndryshe nga mesatarja vjetore. Vitet karakteristike të thata janë: viti 1990 (393 mm) dhe viti 1971 etj., ndërsa vitet karakteristike të lagështa janë: 2014, 1976, 1963, 1979 etj.¹⁹⁶

Reshjet kanë shpërndarje gati të barabartë gjatë stinëve. Në dimër bien 21,5% e reshjeve, në pranverë 26,4%, në verë 26,2% dhe në vjeshtë 25,9%. Trashësia maksimale e borës ka arritur në 43 cm, ndërsa qëndrueshmëria e shtresës me borë

¹⁹³ Ibid.

¹⁹⁴ Ibid.

¹⁹⁵ Vendbanimet e Kosovës, 2018, p. 22.

¹⁹⁶ Ibid.

ka zgjatur deri në 47 ditë. Numri mesatar i ditëve me borë sillet nga 10,2 (janar), 8,3 (shkurt), deri në 8,1 ditë (dhjetor).¹⁹⁷

Rrymimet e ajrit në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik kushtëzohen nga shpërndarja hapësinore e sistemeve barike të qëndrueshme ose sezonale, që krijohen mbi pjesën veriore të Atlantikut, Europës dhe Azisë, si dhe depresioneve sekondare në pjesën perëndimore të Gadishullit Apenin (gjiri i Gjenovës). Erërat lokale në Kosovë kryesisht interferojnë me ato regjionale, mirëpo drejtimi dhe shpejtësia e tyre ndikohen në shkallë të lartë nga topografia e terrenit. Në pjesët lindore të Kosovës rastisje më të madhe kanë rrymimet ajrore nga kahu verior. Në pjesën e ftohtë të vitit ato sjellin masa të ftohta dhe të thata të ajrit, si dhe mot të kthjellët që mund të zgjasë nga disa ditë deri në disa javë.¹⁹⁸

Në pjesën qendrore të rrafshit të Kosovës kryesisht mbizotërojnë erërat nga kahu verior dhe verilindor. Në Prishtinë rastisje mesatare më të madhe kanë erërat nga veriu me rreth 171,2% ($V=2,6$ m/s) dhe verilindje me rreth 142,3% ($V=2,4$ m/s) mirëpo era nga drejtimi juglindje me rastisje më të vogël prej 62,2% ka shpejtësinë mesatare maksimale prej 2,8 m/s. Në ecurinë vjetore erërat në Prishtinë kanë rastisje më të madhe gjatë muajve mars dhe prill, kurse muajin më të qetë të vitit dallohen gushti dhe dhjetori. Prishtina dallohet si qendër me rastisje më të madhe të qetësisë rreth 426%.¹⁹⁹ Teritori i Prishtinës shpeshherë përfshihet nga erërat e fuqishme, mesatarja e shpejtësisë së erës është 3.5 m/s²⁰⁰.

Gjatë periudhave të ndryshme të vitit paraqiten erërat të forta dhe me karakter të shtërngatave lokale, të cilat shoqërohen me dëme materiale. Erëra të forta me shpejtësi prej 17,2-20,7 m/sek (shkalla VIII e Boforit) paraqiten gjatë gjithë vitit, me koncentrim më të madh gjatë dimrit dhe pranverës, kurse më rrallë gjatë verës dhe vjeshtës. Prishtina ka klimë kontinentale, e cila karakterizohet me dimra të ftohtë e të gjatë dhe vera të ngrohta e të thata.²⁰¹

¹⁹⁷ Ibid.

¹⁹⁸ Ibid.

¹⁹⁹ Ibid.

²⁰⁰ Ibid.

²⁰¹ Ibid.

2.9.5 ZHURMA DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE

Ndotja akustike është veçanërisht e rëndë në vendet në zhvillim dhe kjo i përket edhe Prishtinës.²⁰² Sipas matjeve të bëra nga INKOS, në Prishtinë janë gjithsej 3 vende ku tregohet se niveli i zhurmës është më i lartë sesa limiti i lejuar.²⁰³

Kjo ndotje i detyrohet kryesisht trafikut rrugor ku në zonat e dendura të trafikut rrugor, nivelet e presionit akustik gjatë ditës mund të arrijnë 70 dB (A). Burimet kryesore të zhurmës së mjedisit përfshijnë: trafikun, industrinë, ndërtimin etj. Matje të nivelit të zhurmës ka edhe Komuna e Prishtinës në pjesë të ndryshme të qytetit, por akoma nuk ka matje të përditshme, siç e definojnë Ligji për mbrojtjen nga zhurma Për arritjen e qëllimeve të cekura, duhet të hartohen dy dokumente themelore, të cilat trajtojnë të gjitha aspektet e efekteve të zhurmës: Harta Strategjike e zhurmës dhe Plani i Veprimet për mbrojtje nga zhurma.²⁰⁴

Menaxhimi i mbeturinave bëhet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., që mbulon zonën urbane dhe 12 fshatra të komunës. Nuk ka ndarje të mbeturinave mes zonave urbane dhe rurale të Prishtinës. Nuk ka mbledhje të selektuar të mbeturinave, megjithëse kohëve të fundit po bëhen përpjekje që të implementohet ky sistem në disa zona të caktuara të qytetit. Sasia vjetore e mbeturinave që mbledhet nga Kompania Rajonale “Pastrimi” Sh.A. është 1478.80 tonë/vit (mbeturina sanitare) dhe 4,604 tonë/vit (mbeturina josanitare), të cilat përbëjnë një total prej 87,267 tonë/vit (duke iu referuar vitit 2012). Një problem specifik mjedisor paraqitet nga gropat 17 josanitare, si ajo Marec 1 dhe Marec 2 deri te Përroi i Djaloshit – miniera e Artanës, që janë gropat të mbushura me metale të rënda në sipërfaqe prej 2,38 ha.²⁰⁵

Sipas Planit Zhvillimor Urban mënyra e trajtimit të mbeturinave është hartimi i “Strategjinë për trajtim të mbeturinave, hedhurinave, përpunimin dhe bartjen e tyre”. Sipas kësaj strategjie deponia ekzistuese duhet të rigjenerohet me gjelbërim shtesë dhe në atë drejtim të merren masa të tjera të nevojshme; Komuna e Prishtinës të bëjë, po ashtu, “Strategjinë për ujë të pijes dhe trajtim të ujërave të zeza”, me të cilën do të definohen dhe përcaktohen masat dhe veprimet; Hedhja e mbeturinave dhe e ujërave të zeza, duhet të bazohen në dokumentin strategjik për t’u hartuar nga Komuna e Prishtinës, me parime për qëndrueshmëri dhe efikasitet financiar; Riciklim dhe ripërdorim për energji ripërtëritëse dhe prodhimin e biomasave.

Hartimi i programe dhe politika vetëdijësuese për trajtimin e ujit të pijes, shfrytëzimin e tij. Për zonën urbane të Prishtinës dhe komunat fqinje të themelohet .²⁰⁶

²⁰² Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës 2012-2022, 2013, p. 41.

²⁰³ Ibid., p. 16.

²⁰⁴ Ibid., p. 41.

²⁰⁵ Ibid., p. 16.

²⁰⁶ Ibid.

3 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë kapitull sqarohet qasja e kërkimit shkencor e cila është përdorur, duke pretenduar që të studiohet më shumë rreth urbanizimit dhe interaksionin që qëndron në mes të urbanizimit dhe mjedisit, duke qenë se urbanizimi ka implikime të ndryshme në mjedis. Realizimi i këtij punimi është bërë duke u bazuar në të dhëna primare, ku për të realizuar objektiven dhe studimin është përdorur metoda kuantitative dhe kualitative.

Pjesë e hulumtimit kuantitativ ishin arkitektët e Prishtinës nga të cilët kemi marrë informata të ndryshme rreth urbanizimit, prioriteteve të cilat ata i zbatojnë gjatë projekteve, si dhe interaksionin që qëndron në mes të urbanizimit dhe mjedisit. Kurse pjesë e hulumtimit kualitativ ishin zyrtarët e drejtorisë së urbanizimit, si dhe disa ekspertë të urbanizimit nga të cilët kemi marrë informata rreth sfidave të urbanizimit dhe implikimet që mund të ketë.

Definimi i variablave: Variabël e varur në këtë punim është ambienti, kurse variabël e pavarur është urbanizimi.

3.1 POPULLACIONI DHE MOSTRA E PËRFSHIRË NË STUDIM DHE PROCEDURA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Popullatë e këtij studimi për hulumtimin kuantitativ ishin arkitektët e Prishtinës, ku mostër ishin 50 arkitektë. Përzgjedhja e arkitektëve për t'u anketuar është bërë sipas metodës Random dhe përmes programit SPSS. Kurse pjesë e hulumtimit kualitativ ishin 5 zyrtarë nga drejtorja e urbanizimit dhe ekspertë të fushës.

Pyetësi i përdorur për hulumtimin kuantitativ është krijuar përmes Google Forms si dhe shpërndarja e tyre është bërë në formë elektronike, kurse realizimi i hulumtimit kualitativ është bërë duke i shpërndarë intervistat personalisht në drejtorinë e urbanizimit dhe tek ekspertët e fushës.

3.2 INSTRUMENTI I STUDIMIT

Pyetësi për arkitektë është formuluar sipas shkallës Likert, ku përmes Google Forms është shpërndarë tek arkitektët, pastaj përpunimi i të dhënave është realizuar përmes programit SPSS, versioni 25.

Pyetësi është formuluar duke u ndarë në katër pjesë, në hyrje është shpjeguar ideja dhe mënyra si do të plotësohet pyetësi, pas kësaj pyetjet demografike, pjesa për prioritete që i kushtojnë arkitektët gjatë projektimit, pjesa e urbanizimit dhe ajo e mjedisit për të parë interaksionin në mes të mjedisit dhe urbanizimit.

Përveç kësaj, rëndësi ka edhe besueshmëria e pyetësorit, e cila matet duke u bazuar në vlerën e koeficientit Cronbach Alpha, kusht tejet i rëndësishëm për të bërë analiza dhe diskutim të rezultateve. Për të parë besueshmërinë e pyetësorit për secilën kategori, shiko tabelën e më poshtme:

Tabela 12: Besueshmëria e pyetësorit

| Kategoritë e pyetësorit | Vlera e Alfa Cronbach |
|-------------------------|-----------------------|
| Urbanizimi | 0.944 |
| Mjedisi | 0.987 |

Burimi: I imi.

Kur vlerat e besueshmërisë rezultojnë afër 1, themi që pyetësori ka besueshmëri të lartë, mirëpo nëse vlera e këtij koeficienti janë në mes 0.7 dhe 0.8 konstatojmë se besueshmëria e instrumentit është e pranueshme. Besueshmëria e urbanizimit është $\alpha = 0.944$ dhe besueshmëria e mjedisit është $\alpha = 0.987$. Pra besueshmëria e gjithë pyetësorit është $\alpha = 0.965$ e cila nënkupton se pyetësori ka besueshmëri të pranueshme.

3.3 PËRDORIMI I TESTEVE STATISTIKORE MBI HULUMTIMIN

Paraqitja e rezultateve është bërë përmes analizave deskriptive dhe përqindjeve në formë tabelare dhe grafike. Para vërtetimit të hipotezës është realizuar testi i normalitetit (testi Kolmogoriv - Smirnov dhe Shapiro – Wilk) për të parë shpërndarjen e të dhënave. Duke qenë se shpërndarje normale e të dhënave ishte normale, vërtetimi i hipotezës është bërë përmes analizës së korrelacionit dhe regresionit të thjeshtë linear.

4 ANALIZA E HULUMTIMIT

4.1 TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Sipas tabelës së mëposhtme, 40% e arkitektëve të anketuar janë të gjinisë femërore dhe 60% të gjinisë mashkullore.

Tabela 2: Gjinia

| | | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
|-------|----------|-----------|---------|---------------|--------------------|
| Valid | Femër | 20 | 40.0 | 40.0 | 40.0 |
| | Mashkull | 30 | 60.0 | 60.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |

Burimi: I imi.

Sipas statistikave të më poshtme, 40% e arkitektëve të anketuar ishin të moshës 18 – 25 vjeç, 54% ishin të moshës 26 – 33 vjeç dhe 6% ishin të moshës 42 – 49 vjeç.

Tabela 3: Moshë

| | | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
|-------|--------------|-----------|---------|---------------|--------------------|
| Valid | 18 - 25 vjeç | 20 | 40.0 | 40.0 | 40.0 |
| | 26 - 33 vjeç | 27 | 54.0 | 54.0 | 94.0 |
| | 42 - 49 vjeç | 3 | 6.0 | 6.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |

Burimi: I imi.

Bazuar në tabelën e më poshtme shikojmë që 68% e arkitektëve ishin me studimeve Bachelor dhe 32% ishin me studime master.

Tabela 4: Niveli i edukimit


| | | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
|-------|----------|-----------|---------|---------------|--------------------|
| Valid | Bachelor | 34 | 68.0 | 68.0 | 68.0 |
| | Master | 16 | 32.0 | 32.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |

Burimi: I imi

5. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI I GJETJEVE

Sipas grafikut të mëposhtëm, 44% e arkitektëve e kanë konsideruar jashtëzakonisht të rëndësishme fokusimin në hapësirën e gjelbër gjatë projeksioneve të tyre, 34% shumë të rëndësishme, 12% rëndësi mesatare dhe 10% theksuan që fokusimi në hapësirën e gjelbër nuk është aspak e rëndësishme kur ata bëjnë projeksione.


Grafikoni 1. Fokusimi në hapësirën e gjelbër



Burimi: I imi.

Sipas grafikut të mëposhtëm, 6% e arkitektëve e vlerësuan si jashtëzakonisht të rëndësishme fokusimin në orientimin nga lindja, 48% si shumë të rëndësishme, 36% rëndësi mesatare, 4% rëndësi të ulët dhe vetëm 6% e arkitektëve e vlerësuan si aspak të rëndësishme.


Grafikoni 2. Fokusimi në orientimin nga lindja



Burimi: I imi.

Sipas grafikut të mëposhtëm, 62% e arkitektëve e vlerësuan si jashtëzakonisht të rëndësishme fokusimin në shfrytëzimin e hapësirës gjatë projeksioneve të tyre, 32% si shumë të rëndësishme, dhe vetëm 6% i kushtuan rëndësi mesatare.


Grafikoni 3. Fokusimi në shfrytëzimin e hapësirës



Burimi: I imi.

Referuar grafikut të mëposhtëm, 38% e arkitektëve theksuan që gjatë projeksioneve e cilësojnë si jashtëzakonisht të rëndësishme fokusimin në dizajn, 52% e vlerësuan si shumë të rëndësishme dhe 10% e tyre ishin për opsionin me rëndësi të ulët.


Grafikoni 4. Fokusimi në dizajn



Burimi: I imi.

Sipas statistikave të mëposhtme, 40% e arkitektëve e cilësuan fokusimin në ndriçim si jashtëzakonisht të rëndësishme gjatë projeksioneve, 46% shumë të rëndësishme, 8% rëndësi mesatare dhe 6% rëndësi të ulët.


Grafikoni 5. Fokusimi në ndriçim



Burimi: I imi.

Sipas statistikave të mëposhtme, 56% e arkitektëve e cilësuan fokusimin në izolim si jashtëzakonisht të rëndësishme gjatë projeksioneve, 18% shumë të rëndësishme, 22% rëndësi mesatare dhe 4% rëndësi të ulët.


Grafikoni 6. Fokusimi në izolim



Burimi: I imi.

Sa i përket përkrahjes së pushtetit lokal për zhvillim urbanistik në figurën e mëposhtme, shikojmë që 12% e arkitektëve të anketuar u pajtuan që pushteti lokal jep përkrahje të vazhdueshme për zhvillim urbanistik, 18% ishin neutral, 42% nuk u pajtuan dhe 28% nuk u pajtuan aspak që marrin një përkrahje të tillë nga pushteti lokal.


Grafikoni 7. Përkrahja e pushtetit lokal për zhvillim urbanistik



Burimi: I imi.

Referuar figurës së mëposhtme, 12% e arkitektëve të anketuar ishin plotësisht të pajtimit të janë të informuar për reformën e kornizës ligjore për planifikim hapësinor, 34% u pajtuan, 36% ishin neutral, 14% nuk u pajtuan dhe 4% nuk u pajtuan aspak që kanë një informim të tillë.


Grafikoni 8. Informimi lidhur me reformën e kornizës ligjore në planifikimin hapësinor



Burimi: I imi.

Sipas analizës së mëposhtme, 18% e arkitektëve ishin plotësisht të pajtimit që posedojnë informacion për planin zhvillimor të Prishtinës. 50% u pajtuan, 18% ishin neutral, 10% nuk u pajtuan dhe 4% nuk u pajtuan aspak që posedojnë një informacion të tillë.


Grafikoni 9. Posedimi i informacionin për planin zhvillimor të Prishtinës



Burimi: I imi.

Sa i përket kontrollës nga drejtoria e urbanizmit, sipas grafikut të më poshtëm shikojmë që 12% ishin plotësisht të pajtimit që ka kontroll nga drejtoria e urbanizmit sa i përket respektimit të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës, 16% u pajtuan, 26% ishin neutral, 24% nuk u pajtuan dhe 22% nuk u pajtuan aspak që kanë kontroll sa i përket respektimit të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës.


Grafikoni 10. Kontroll nga drejtoria e urbanizmit sa i përket respektimit të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës



Burimi: I imi.

Respektimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës është një element tjetër i trajtuar në këtë analizë, ku 48% e arkitektëve ishin plotësisht të pajtimit që e respektojnë këtë ligj, 36% e arkitektëve u pajtuan, 10% ishin neutral dhe 6% nuk u pajtuan.


Grafikoni 11. Respektimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës



Burimi: I imi.

Sipas arkitektëve, rritja e numrit të popullsisë e cila vjen në zonën urbane të Prishtinës është dukuri në rritje duke qenë se 78% e tyre ishin plotësisht të pajtimit, 16% u pajtuan dhe 5% ishin neutral duke qenë se nuk kishin informatë nëse kjo me të vërtetë është një dukuri në rritje.


Grafikoni 12. Rritja e numrit të popullsisë e cila vjen në zonën urbane të Prishtinës



Burimi: I imi.

Sipas arkitektëve, 46% u pajtuan plotësisht që ka rritje të kërkesës që tokat bujqësore të kthehen në toka ndërtuese urbane, 30% u pajtuan, 18% ishin neutral dhe 6% nuk u pajtuan.


Grafikoni 13. Rritja e kërkesës së tokat bujqësore të kthehen në toka ndërtuese urbane



Burimi: I imi.

Duke u bazuar në grafikun e mëposhtëm, 60% e arkitektëve ishin plotësisht pajtimit që ka ekspansion të numrit të ndërtimeve në Prishtinë, 24% u pajtuan dhe 16% ishin neutral.


Grafikoni 14: Ekspansioni i numrit të ndërtimeve në Prishtinë



Burimi: I imi.

Referuar grafikut, 30% e arkitektëve u pajtuan plotësisht të pajisja me leje të ndërtimit është si dukuri në rritje, 38% u pajtuan, 28% ishin neutral dhe vetëm 4% nuk u pajtuan aspak që kjo është dukuri në rritje.


Grafikoni 15. Pajisja me leje e ndërtimeve si dukuri në rritje



Burimi: I imi.

Sipas arkitektëve të anketuar, 6% e tyre u pajtuan që ndërtimet e projektuara posedojnë hapësirë të gjelbër dhe rekreative, 18% ishin neutral, 58% nuk u pajtuan që ndërtimet posedojnë hapësirë të tillë dhe 15% nuk u pajtuan aspak. Pra, dukuria e ndërtimeve të cilat nuk posedojnë hapësirë të gjelbër dhe rekreative është shumë e shprehur.


Grafikoni 16. Posedimi i ndërtimeve me hapësirë të gjelbër dhe rekreative



Burimi: I imi.

Sa i përket qasjes në shërbimet komunale, 28% e arkitektëve u pajtuan që zona urbane kanë qasje në shërbimet komunale, 34% ishin neutral sepse nuk ishin të sigurt, 26% nuk u pajtuan dhe 12% nuk u pajtuan aspak që këto zona kanë qasje në shërbimet komunale.


Grafikoni 17. Qasja e ndërtimeve në shërbimet komunale



Burimi: I imi.

Sipas grafikut të më poshtëm shikojmë që menaxhimi i mbeturinave sipas standardeve evropiane për ndarje dhe riciklim është një problem tejet i madh duke qenë se 70% e arkitektëve nuk u pajtuan që bëhet ndarja e mbeturinave për ndarje dhe riciklim, kurse 10% ishin neutral duke qenë se nuk e kishin një informatë të tillë. Opsionet pajtohem nuk kishin asnjë përqindje.


Grafikoni 18. Menaxhimi i mbeturinave sipas standardeve evropiane për ndarje dhe riciklim.



Burimi: I imi.

Referuar grafikut të më poshtëm. 24% e arkitektëve pajtohen që transporti publik ka shtrirje në territorin e Prishtinës dhe linjat janë të rregullta, 40% ishin neutral, 30% nuk pajtohen dhe 6% nuk pajtohen aspak që transporti ka shtrirje dhe është i rregullt.


Grafikoni 19. Shtrirja e transportit publik në territorin e Prishtinës dhe rregullsia e linjave



Burimi: I imi.

Sipas arkitektëve, shikojmë që plani urbanistik nuk ka konsistencë ndër vite duke qenë se 50% nuk u pajtuan me këtë pohim, 34% ishin neutral dhe 16% u pajtuan.


Grafikoni 20. Konsistenca e planit urbanistik ndër vite



Burimi: I imi.

Sipas arkitektëve të anketuar shikojmë që 50% e tyre nuk u pajtuan që operatorët ekonomik posedojnë filtra në oxhaqe të ngrohjes dhe oxhaqeve të tjerë. 38% ishin neutral duke qenë se kishin mungesë të informacionit dhe vetëm 12% u pajtuan.


Grafikoni 21. Posedimi i filtrave në oxhaqe të ngrohjes etj nga operatorët ekonomik



Burimi: I imi.

Sipas statistikave, 42% e arkitektëve ishin neutral se i përket posedimit të impianteve për trajtimi të ujërave të zeza në zonat e tyre urbane, kurse 50% nuk u pajtuan. Rreth 6% nuk e plotësuan këtë pyetje duke qenë se nuk kishin informatë.


Grafikoni 22. Posedimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza



Burimi: I imi.

Sipas arkitektëve shikojmë që posedimi i parkingjeve të mjaftueshëm në Prishtinë është një problem i madh duke qenë se 72% e arkitektëve deklaruan që nuk pajtohen me këtë pohim dhe vetëm 18% ishin të pajtimit që Prishtina ka parkingje të mjaftueshme.


Grafikoni 23. Posedimi i parkingjeve të mjaftueshme në Prishtinë



Burimi: I imi.

Lehtësia e qasjes së lagjeve në institucionet komunale është një indikator i rëndësishëm ku sipas arkitektëve 38% nuk u pajtuan që zonat kanë lehtësi të qasjes në institucionet komunale, 12% nuk u pajtuan, 28% ishin neutral dhe 22% u pajtuan me këtë


Grafikoni 24. Lehtësia e qasjes së lagjeve në institucionet komunale



Burimi: I imi.

Referuar grafikut të më poshtëm shikojmë që 40% e arkitektëve të anketuar nuk u pajtuan që Prishtina posedon ndriçim publik në pjesët urbane të qytetit, 34% ishin neutral dhe 26% u pajtuan që kanë ndriçim publik.

Grafikoni 25. Posedimi i ndriçimit publik në pjesët urbane të Prishtinës



Burimi: I imi.

Fokusimi i arkitektëve në indikatorë të ndryshëm projektues është shumë e rëndësishme, ku nga 50 arkitekt të anketuar shikojmë që nga minimumi 1 dhe maksimumi 5 i shkallës Likert, mesatarja e hapësirës së gjelbër është $\bar{x} = 4.02$, mesatarja e orientimit nga lindja është $\bar{x} = 3.44$, shfrytëzimi i hapësirës kishe mesatare $\bar{x} = 4.56$, dizajni kishte mesatare $\bar{x} = 4.18$, kosto kishte mesatare $\bar{x} = 3.82$, ndriçimi kishte mesatare $\bar{x} = 4.20$ dhe izolimi me mesatare $\bar{x} = 4.26$. Sipas mesatareve shikojmë që arkitektët më së paku i kushtojnë rëndësi që plani urbanistik të ketë orientim nga lindja dhe koston së projektimit dhe ndërtimit, kurs rëndësinë më të madhe i kushtojnë izolimit dhe shfrytëzimit të hapësirës.

Tabela 5. Analiza deskriptive për rëndësinë e faktorëve të ndryshëm gjatë projektimit

| Descriptive Statistics | | | | | |
|---|----|---------|---------|------|----------------|
| Gjatë projektimit sa i kushton rëndësi: | N | Minimum | Maximum | Mean | Std. Deviation |
| Hapësirës së gjelbër | 50 | 1 | 5 | 4.02 | 1.220 |
| Orientimi kah lindja | 50 | 1 | 5 | 3.44 | 0.907 |
| Shfrytëzimi i hapësirës | 50 | 3 | 5 | 4.56 | 0.611 |
| Dizajni | 50 | 2 | 5 | 4.18 | 0.873 |
| Kostos | 50 | 3 | 5 | 3.82 | 0.850 |
| Ndriçimi | 50 | 2 | 5 | 4.20 | 0.833 |
| Izolimi | 50 | 2 | 5 | 4.26 | 0.944 |

| | | | | | |
|--------------------|----|--|--|--|--|
| Valid N (listwise) | 50 | | | | |
|--------------------|----|--|--|--|--|

Burimi: I imi.

Sipas statistikave të më poshtme të cilat paraqesin mesataren e pohimeve të urbanizimit shikojmë që mesatarja e “Pushteti lokal jep përkrahje të mjaftueshme për zhvillimin urbanistik” ka mesataren $\bar{x} = 2.14$; “Kam informata të mjaftueshme lidhur me reformën e kornizës ligjore në planifikimin hapësinor” ka mesataren $\bar{x} = 3.36$; “Kam informata të mjaftueshme për planin zhvillimor urban të Prishtinës” ka mesataren $\bar{x} = 3.68$; “Kemi kontroll të vazhdueshme nga drejtoria e urbanizimit sa i përket respektimit të Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës” ka mesataren $\bar{x} = 2.72$; “Respektoj plotësisht Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës” ka mesataren $\bar{x} = 4.26$; “Ka rritje të numrit të popullsisë e cila vjen në zonën urbane të Prishtinës” ka mesataren $\bar{x} = 4.72$; “Ka rritje të kërkesës që tokat bujqësore të kthehen në toka ndërtuese urbane” ka mesataren $\bar{x} = 4.16$; “Prishtina ka ekspansion të numrit të ndërtimeve” ka mesataren $\bar{x} = 4.44$.

Bazuar në mesataret e më poshtme, nga minimumi 1 dhe maksimumi 5, shikojmë pushteti lokal nuk jep përkrahje të mjaftueshme për zhvillim urbanistik dhe nuk kanë kontroll të vazhdueshme nga drejtoria e urbanizimit sa i përket respektimit të Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës. Kurse sipas mestrarëve shikojmë që rritje të numrit të popullsisë e cila vjen në zonën urbane të Prishtinës dhe se arkitektët e respektojnë Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës në mënyrë të kënaqshme.

Tabela 6. Analiza deskriptive për urbanizimin

| Descriptive Statistics | | | | | |
|---|----|-----|-----|------|----------------|
| | N | Min | Max | Mean | Std. Deviation |
| Pushteti lokal jep përkrahje të mjaftueshme për zhvillimin urbanistik. | 50 | 1 | 4 | 2.14 | 0.969 |
| Kam informata të mjaftueshme lidhur me reformën e kornizës ligjore në planifikimin hapësinor. | 50 | 1 | 5 | 3.36 | 1.005 |
| Kam informata të mjaftueshme për planin zhvillimor urban të Prishtinës. | 50 | 1 | 5 | 3.68 | 1.019 |
| Kemi kontroll të vazhdueshme nga drejtoria e urbanizimit sa i përket respektimit të Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës. | 50 | 1 | 5 | 2.72 | 1.310 |

| | | | | | |
|--|----|---|---|------|-------|
| Respektoj plotësisht Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës. | 50 | 2 | 5 | 4.26 | 0.876 |
| Ka rritje të numrit të popullsisë e cila vjen në zonën urbane të Prishtinës. | 50 | 3 | 5 | 4.72 | 0.573 |
| Ka rritje të kërkesës që tokat bujqësore të kthehen në toka ndërtuese urbane | 50 | 2 | 5 | 4.16 | 0.934 |
| Prishtina ka ekspansion të numrit të ndërtimeve. | 50 | 3 | 5 | 4.44 | 0.760 |
| Valid N (listwise) | 50 | | | | |

Burimi: I imi.

Sipas tabelës së më poshtme e cila shpreh mesataret për ambientin, shikojmë që pohimet “Ndërtimet të cilat pajisen me leje janë dukuri në rritje” ka mesataren $\bar{x} = 3.90$; “Ndërtimet posedojnë hapësirë të gjelbër dhe rekreative” ka me mesataren $\bar{x} = 2.12$; “Ndërtimet posedojnë qasje në shërbimet komunale” ka me mesataren $\bar{x} = 2.78$; “Mbeturinat menaxhohen sipas standardeve evropiane për ndarje dhe riciklim” ka me mesataren $\bar{x} = 1.66$; “Transporti publik është i shtrirë në tërë territorin e Prishtinës dhe ka linja të rregullta” ka me mesataren $\bar{x} = 2.82$; “Plani urbanistik është konsistent ndër vite” ka me mesataren $\bar{x} = 2.50$; “Operatorët ekonomik kanë filtra të vendosur në oxhaqe të ngrohjes, etj” ka me mesataren $\bar{x} = 2.56$; “Prishtina ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza” ka me mesataren $\bar{x} = 2.19$; “Pjesa urbane e Prishtinës ka parkingje të mjaftueshme” ka me mesataren $\bar{x} = 1.82$; “Të gjitha lagjet kanë qasje të lehtë në institucionet komunale” ka me mesataren $\bar{x} = 2.60$; “Pjesët urbane të Prishtinës kanë ndriçim publik” ka me mesataren $\bar{x} = 2.86$.

Bazuar në mesatare shikojmë që gjendja më e mirë është sa i përket lejeve të ndërtimeve të cilat konsiderohen si dukuri në rritje, kurse sipas arkitektëve shikojmë që në zonat urbane nuk menaxhohen mbeturinat sipas standardeve evropiane për ndarje dhe riciklim, posedimi i parkingjeve është shumë i ulët si dhe ka mungesë të hapësirave të gjelbërta dhe rekreative.

Tabela 7. Analiza deskriptive për Ambientin

| Descriptive Statistics | | | | | |
|---|----|-----|-----|------|----------------|
| | N | Min | Max | Mean | Std. Deviation |
| Ndërtimet të cilat pajisen me leje janë dukuri në rritje. | 50 | 1 | 5 | 3.90 | 0.974 |
| Ndërtimet posedojnë hapësirë të gjelbër dhe rekreative. | 50 | 1 | 4 | 2.12 | 0.773 |
| Ndërtimet posedojnë qasje në shërbimet komunale. | 50 | 1 | 4 | 2.78 | 0.996 |

| | | | | | |
|--|----|---|---|------|-------|
| Mbeturinat menaxhohen sipas standardeve evropiane për ndarje dhe riciklim. | 50 | 1 | 3 | 1.66 | 0.658 |
| Transporti publik është i shtrirë në tërë territorin e Prishtinës dhe ka linja të rregullta. | 50 | 1 | 4 | 2.82 | 0.873 |
| Plani urbanistik është konsistent ndër vite. | 50 | 1 | 4 | 2.50 | 0.953 |
| Operatorët ekonomik kanë filtra të vendosur në oxhaqe të ngrohjes, etj. | 50 | 1 | 4 | 2.56 | 0.787 |
| Prishtina ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza. | 47 | 1 | 3 | 2.19 | 0.825 |
| Pjesa urbane e Prishtinës ka parkingje të mjaftueshme. | 50 | 1 | 4 | 1.82 | 1.119 |
| Të gjitha lagjet kanë qasje të lehtë në institucionet komunale. | 50 | 1 | 4 | 2.60 | 0.969 |
| Pjesët urbane të Prishtinës kanë ndriçim publik. | 50 | 2 | 4 | 2.86 | 0.808 |
| Valid N (listwise) | 47 | | | | |

Burimi: I imi.

Para se të fillohet me vërtetimin e hipotezave, është realizuar testi i normalitetit, testin Kolmogoriv - Smirnov dhe Shapiro – Wilk për të parë nëse kemi shpërndarje normale apo jo. Duke qenë se $p = .200 > .05$, atëherë kemi shpërndarje normale të të dhënave dhe kushti për analizën e korrelacionit dhe regresionit linear është plotësuar.

Tabela 8. Testi i shpërndarjes së të dhënave

| Tests of Normality | | | | | | |
|--------------------|---------------------------------|----|------|--------------|----|------|
| | Kolmogorov-Smirnov ^a | | | Shapiro-Wilk | | |
| | Statistic | Df | Sig. | Statistic | df | Sig. |
| Përformanca | .049 | 50 | .200 | .973 | 50 | .105 |

a. Lilliefors Significance Correction

Burimi: I imi.

Koeficienti i korrelacionit është përdorur për të matur marrëdhëniet në mes dy ndryshoreve, ndryshores së varur dhe të pavarur. Dhe në këtë rast variabël e varur është ambienti, kurse variabël e pa varur është urbanizimi. Koeficienti i korrelacionit mes dy variablave është $r = .469$, që do të thotë se ekziston një marrëdhënie lineare pozitive e dobët mes ambientit dhe urbanizimit. Meqenëse ekziston një lidhje pozitive midis variablave të varur dhe të pavarur, edhe dhe $p < 0.01$, refuzojmë

automatiksht hipotezën H_0 dhe pranojmë hipotezën alternative H sepse shohim që ka ndërlidhje statistikisht signifikante që urbanizimi ndikon në ambient.

Tabela 9. Analiza e korrelacionit

| Correlations | | | |
|--------------|---------------------|------------|----------|
| | | Urbanizimi | Ambienti |
| Urbanizimi | Pearson Correlation | 1 | .469** |
| | Sig. (2-tailed) | | 0.001 |
| | N | 50 | 50 |
| Ambienti | Pearson Correlation | .469** | 1 |
| | Sig. (2-tailed) | 0.001 | |
| | N | 50 | 50 |

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Burimi: I imi.

Në tabelën e mëposhtme është e paraqitur R Square e cila tregon se sa përqind e ndryshores së varur që në rastin tonë është ambienti, shpjegohet nga ndryshorja e pa varur që është urbanizimi.

Pra, 22% e variablës së varur (ambienti) shpjegohet nga urbanizimi, ndërsa pjesa tjetër prej 78% shpjegohet me ndryshore që nuk përfshihen në model nga ndonjë gabim rastësor. Prandaj, nëse numri i variablave të pavarur rritet në model, rritet edhe vlera e R – square.

Testi Durbin Watson tregon nëse ka autokorrelacion në model apo jo. Në rastin tonë ne shohim se problemi i autokorrelacionit nuk ekziston pasi vlera e testit Durbin Watson është 2.30.

Tabela 10. Model Summary^b për ndikimin e urbanizimit në ambient

Model Summary^b

| Model | R | R Square | Adjusted R Square | Std. Error of the Estimate | Change Statistics | | | | | Durbin-Watson |
|-------|-------------------|----------|-------------------|----------------------------|-------------------|----------|-----|-----|---------------|---------------|
| | | | | | R Square Change | F Change | df1 | df2 | Sig. F Change | |
| 1 | .469 ^a | 0.220 | 0.204 | 0.40963 | 0.220 | 13.570 | 1 | 48 | 0.001 | 2.307 |

a. Predictors: (Constant), Urbanizimi

b. Dependent Variable: Ambienti

Burimi: I imi.

Tabela ANOVA shpreh rëndësinë e modelit në tërësi. Duke qenë se vlera e F = 13,570 dhe domethënia p = 0,000 tregon që modeli i përdorur është i rëndësishëm në secilin nivel.

Tabela 13. ANOVA për ndikimin e urbanizimit në ambient

ANOVA^a

| Model | | Sum of Squares | df | Mean Square | F | Sig. |
|-------|------------|----------------|----|-------------|--------|-------------------|
| 1 | Regression | 2.277 | 1 | 2.277 | 13.570 | .001 ^b |
| | Residual | 8.054 | 48 | 0.168 | | |
| | Total | 10.331 | 49 | | | |

a. Dependent Variable: Ambienti

b. Predictors: (Constant), Urbanizimi

Burimi: I imi.

Nga tabela e regresionit shohim që edhe nëse vlera e urbanizimit do të jetë 0, ambienti do të jetë 0.445 njësi. Me rritjen e një njësie në urbanizim, ambienti do të rritet për 0.565 njësi. Pra ka ndërlidhje statistikisht signifikante që urbanizimi ndikon në ambient, sepse sa më e urbanizuar të jetë zona, do të ketë më shumë implikime në mjedis.

Tabela 14. Analiza e koeficienteve për ndikimin e urbanizimit në ambient

Coefficients^a

| Model | | Unstandardized Coefficients | | Standardized Coefficients | t | Sig. |
|-------|------------|-----------------------------|------------|---------------------------|-------|-------|
| | | B | Std. Error | Beta | | |
| 1 | (Constant) | 0.445 | 0.568 | | 0.783 | 0.000 |
| | Urbanizimi | 0.565 | 0.153 | 0.469 | 3.684 | 0.001 |

a. Dependent Variable: Ambienti

Modeli:

$$y = \beta_0 + \beta_1 + \varepsilon$$

y – Ambienti

x_1 – Urbanizimi

$$y_{(Ambienti)} = 0.445 + 0.565 * x_1_{(Urbanizimi)}$$

Burimi: I imi.

5.1 REZULTATET E HULUMTIMIT KUALITATIV

A është plani urbanistik i Prishtinës në harmoni me kërkesën dhe zhvillimet shoqërore? Nëse po, përse?

Sipas zyrtarëve të urbanizimit, komuna e Prishtinës në detyrë zyrtare miraton leje ndërtimore me Plane Rregulluese, Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Zhvillimor Komunal, ndër të cilat shpesh herë këto plane nuk janë në harmoni me njëra tjetrën dhe vështirësohet shqyrtimi i lëndëve.

Sipas tyre, bazë e çdo planifikim në komunë është analiza e gjendjes ekzistuese në hapësirë, në raport me demografinë, vendbanimet, resurset natyrore, shërbimet publike me infrastrukturë përcjellëse, infrastrukturën teknike dhe mbrojtjen e mjedisit. Analiza e këtyre faktorëve, e bërë në bazë të të dhënave statistikore dhe nga terreni, mundëson vlerësimin e potencialeve dhe kufizimeve zhvillimore të shoqërisë. Lidhur me banimin, si një nga sfidat kryesore është mungesa e ekspertizës së nevojshme për planifikimin e zhvillimit të këtij sektori. Përkundër faktit që shumë nga banesat e ndërtuara janë të pashfrytëzuara, ka presion të vazhdueshëm për ndërtime të reja. Mungesa e tokës komunale për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme për shërbime publike është po ashtu një çështje shumë e rëndësishme.

Ata cilësuan se planet urbanistike janë pjesërisht në harmoni me kërkesat e shoqërisë për faktin se në hartimin e planeve urbanistike zëri i përfshirjes së qytetareve nuk është në pjesëmarrjen e duhur ku se paku 50% e qytetareve dot duhej të përfshiheshin në aprovimin e kërkesave dhe në aspektin profesional mungon infrastruktura rrugore e mjaftueshme për implementim të kërkesave që parashihen me plane urbanistike.

2. Si gjen zbatim plani urbanistik në terren, duke pas parasysh që kemi shumë ndërtues të cilët nuk janë duke e përfillur planin urbanistik?

Sipas zyrtarëve të urbanizimit, pas miratimit të ligjit për ndërtime pa leje është komplikuar zbatimi i planeve urbanistike meqenëse legalizimi nuk i përfill këto plane. Parcelimi i paplanifikuar i ngastrave dhe ndërtimet pa leje e pamundësojnë zbatimin e planeve urbanistike, e cila ndërlidhet edhe me humbjen e tokës bujqësore, e parcelizuar dhe shndërruar në tokë ndërtimore.

Sipas tyre, zbatimi është i pjesshëm varësisht nga mundësia e përfshirjes së pronarëve në zgjidhjet urbane dhe normal interesave të tyre.

Ata theksuan se aty ku plotësohen të gjitha kriteret urbane të përcaktuara me plan rregullues, ndërtimi realizohet sipas lejes ndërtimor, në të kundërtën sipas tyre ndërtuesit pa leje ndërtimore duhet të ndëshkohen nga ligji.

3. Si bëhet përmirësimi i zbatueshmërisë së planit urbanistik?

Sipas zyrtarëve, përmirësimi i zbatueshmërisë së planit urbanistik bëhet pas miratimit të PZHK-së si plan i nivelit me të lartë dhe miratimit të hartave zonale. Ata cilësuan se në përmirësimin e zbatueshmërisë së planit urbanistik ndikon shumë

pjesëmarrja e publikut gjatë hartimit të këtyre dokumenteve. Sipas tyre në këtë mënyrë, qytetarët duke marrë pjesë në hartim të dokumenteve të planifikimit, mishërohen me planet urbanistike, dhe fitojnë ndjenjën e pronësisë mbi planet si dhe angazhohen në zbatimin e tij.

Disa nga zyrtarët rekomanduan përfshirje sa më të madhe të aprovimit të shoqërisë duke shterur në maksimum ankesat dhe zgjidhjen sa më në detale të zgjidhjeve urbane, respektivisht planeve urbane ku fillimisht do të duhej të kemi një plan gjithëpërfshirës si zgjidhje e konceptit të shtrirjes dhe zhvillimit të qytetit duke marrë për bazë në masë të madhe gjendjen faktike dhe mundësitë e zhvillimit, respektivisht zgjerimit të qytetit dhe gjithnjë me kriteret urbane sa më moderne.

Ata po ashtu rekomanduan formimin e një drejtorie që merret me implementimin e planeve.

4. Si e kontrolloni zbatimin e planit urbanistik dhe rregullativave ligjore për urbanizëm?

Sipas zyrtarëve, në Urbanizëm zbatohet plani urbanistik dhe rregullativave ligjore me planet të cilat janë në fuqi (të cilave edhe pse ju ka kaluar afati për revidim akoma punohet me të njëjtat).

Ata theksuan se lidhur me zbatimin e planeve urbanistike duhet të hartohet një udhëzim administrativ përkatës e cila duhet të shërbej si bazë për vlerësimin dhe rishikimin periodik të planeve sipas dispozitave ligjore. Sipas tyre, me kapacitetet aktuale njerëzore në komuna kjo është vështirë e realizueshme.

Gjatë hartimit të rregullativës ligjore për urbanizëm, është shumë e nevojshme që stafi profesional i komunave të jetë i përfshirë në takimet punuese, e cila do të mundësonte shtjellimin e përmbajtjes së ligjit dhe akteve nënligjore duke pasuruar ato me përvoja të drejtpërdrejta nga tereni.

Ata theksuan se gjeodeti i Drejtorisë së Urbanizmit në hartë i ka të evidentuara të gjitha objektet për të cilat lëshohet leje ndërtimore dhe dihet për afërsisht sa janë realizuar planet. Të gjitha kushtet ndërtimore dhe lejet ndërtimore lëshohen në bazë të rregullativave ligjore në fuqi.

6. PËRFUNDIMET E STUDIMIT

Bazuar në gjetjet e studimit vijmë në përfundim që arkitektët e sotëm kanë filluar të kushtojnë rëndësi fokusimit në hapësirat e gjelbërta, në orientimin nga lindja, në shfrytëzimin e hapësirës, në dizajn, ndriçim dhe izolim. Vijnë në përfundim që pushteti lokal nuk jep përkrahje të vazhdueshme për zhvillim urbanistik.

Bazuar në rezultatet e fituara vijmë në përfundim që drejtorja e urbanizmit nuk realizon kontroll sa i përket respektimit të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës, pavarësisht që arkitektët janë deklaruar që e respektojnë Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës.

Sipas përgjigjeve të arkitektëve vijmë në përfundim që ka rritje të kërkesës që tokat bujqësore të kthehen në toka ndërtuese urbane si dhe ka ekspansion të numrit të ndërtimeve në Prishtinë, mirëpo paralelisht me këto është rritur edhe pajisja me leje ndërtimeve si dukuri në rritje.

Edhe pse ka rritje të kërkesës për ndërtime, posedimi i hapësirave të gjelbërta dhe rekreative është një problem i vazhdueshëm, kjo mund të jetë si rrjedhojë e mos kontrollës së drejtorisë së urbanizimit rreth plotësimit të standardeve dhe respektimit të ligjit.

Sipas rezultateve shikojmë që ndërtimet në qytetin e Prishtinës kanë qasje në shërbimet komunale, ka shtrirje të transportit publik në territorin e Prishtinës dhe linjat janë të rregullta, mirëpo posedimi i parkingjeve konsiderohet një problem për qytetin duke qenë se janë mjaftë të limituara hapësirat për të plotësuar kërkesat e të gjithë qytetarëve të Prishtinës dhe më gjerë.

Një tjetër problematikë e identifikuar është mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, mungesa e ndriçimit publik në pjesët urbane të Prishtinës dhe mungesa e konsistencës së planit urbanistik ndër vite.

Koeficienti i korrelacionit mes dy variablave është $r = .469$, që do të thotë se ekziston një marrëdhënie lineare pozitive e dobët mes ambientit dhe urbanizimit. Meqenëse ekziston një lidhje pozitive midis variablave të varur dhe të pavarur, edhe dhe $p < 0.01$, refuzojmë automatikisht hipotezën H_0 dhe pranojmë hipotezën alternative H sepse shohim që ka ndërlidhje statistikisht signifikante që urbanizimi ndikon në ambient.

Bazuar në analizën e regresionit, 22% e variablës së varur (ambienti) shpjegohet nga urbanizimi, ndërsa pjesa tjetër prej 78% shpjegohet me ndryshore që nuk përfshihen në model nga ndonjë gabim rastësor. Prandaj, nëse numri i variablave të pavarur rritet në model, rritet edhe vlera e $R - \text{Square}$.

Sipas zyrtarëve të urbanizimit, vijmë në përfundim se komuna e Prishtinës në detyrë zyrtare miraton leje ndërtimore me Plane Rregulluese, Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Zhvillimor Komunal, ndër të cilat shpesh herë këto plane nuk janë në harmoni me njëra tjetrën dhe vështirësohet shqyrtimi i lëndëve. Sipas tyre, bazë e çdo planifikim në komunë është analiza e gjendjes ekzistuese në hapësirë, në raport me demografinë, vendbanimet, resurset natyrore, shërbimet publike me infrastrukturë përcjellëse, infrastrukturën teknike dhe mbrojtjen e mjedisit.

Analiza e këtyre faktorëve, e bërë në bazë të të dhënave statistikore dhe nga terreni, mundëson vlerësimin e potencialeve dhe kufizimeve zhvillimore të shoqërisë. Lidhur me banimin, si një nga sfidat kryesore është mungesa e ekspertizës së nevojshme për planifikimin e zhvillimit të këtij sektori. Përkundër faktit që shumë nga banesat e

ndërtuara janë të pashfrytëzuara, ka presion të vazhdueshëm për ndërtime të reja. Mungesa e tokës komunale për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme për shërbime publike është po ashtu një çështje shumë e rëndësishme.

Bazuar në hulumtimin kualitativ vijmë në përfundim se planet urbanistike janë pjesërisht në harmoni me kërkesat e shoqërisë për faktin se në hartimin e planeve urbanistike zëri i përfshirjes së qytetareve nuk është në pjesëmarrjen e duhur ku se paku 50% e qytetareve dot duhej të përfshiheshin në aprovimin e kërkesave dhe në aspektin profesional mungon infrastruktura rrugore e mjaftueshme për implementim të kërkesave që parashihen me plane urbanistike.

Bazuar në hulumtimin kualitativ, vijmë në përfundim se pas miratimit të ligjit për ndërtime pa leje është komplikuar zbatimi i planeve urbanistike meqenëse legalizimi nuk i përfill këto plane. Parcelimi i paplanifikuar i ngastrave dhe ndërtimet pa leje e pamundësojnë zbatimin e planeve urbanistike, e cila ndërlidhet edhe me humbjen e tokës bujqësore, e parcelizuar dhe shndërruar në tokë ndërtimore. Sipas tyre, zbatimi është i pjesshëm varësisht nga mundësia e përfshirjes së pronarëve në zgjidhjet urbane dhe normal interesave të tyre.

Sipas zyrtarëve të drejtorisë së urbanizmit vijmë në përfundim se aty ku plotësohen të gjitha kriteret urbane të përcaktuara me plan rregullues, ndërtimi realizohet sipas lejes ndërtimor, në të kundërtën sipas tyre ndërtuesit pa leje ndërtimore duhet të ndëshkohen nga ligji.

Sipas zyrtarëve, vijmë në përfundim se përmirësimi i zbatueshmërisë së planit urbanistik bëhet pas miratimit të PZHK-së si plan i nivelit më të lartë dhe miratimit të hartave zonale. Ata cilësojnë se në përmirësimin e zbatueshmërisë së planit urbanistik ndikon shumë pjesëmarrja e publikut gjatë hartimit të këtyre dokumenteve. Sipas tyre në këtë mënyrë, qytetarët duke marrë pjesë në hartim të dokumenteve të planifikimit, mishërohen me planet urbanistike, dhe fitojnë ndjenjën e pronësisë mbi planet si dhe angazhohen në zbatimin e tij.

Disa nga zyrtarët rekomandojnë përfshirje sa më të madhe të aprovimit të shoqërisë duke shterur në maksimum ankesat dhe zgjidhjen sa më në detale të zgjidhjeve urbane, respektivisht planeve urbane ku fillimisht do të duhej të kemi një plan gjithëpërfshirës si zgjidhje e konceptit të shtrirjes dhe zhvillimit të qytetit duke marrë për bazë në masë të madhe gjendjen faktike dhe mundësitë e zhvillimit, respektivisht zgjerimit të qytetit dhe gjithnjë me kritere urbane sa më moderne.

Sipas zyrtarëve, vijmë në përfundim se në urbanizëm zbatohet plani urbanistik dhe rregullativave ligjore me planet të cilat janë në fuqi (të cilave edhe pse ju ka kaluar afati për revidim akoma punohet me të njëjtat). Ata theksuan se lidhur me zbatimin e planeve urbanistike duhet të hartohet një udhëzim administrativ përkatës e cila duhet të shërbejë si bazë për vlerësimin dhe rishikimin periodik të planeve sipas

dispozitave ligjore. Sipas tyre, me kapacitetet aktuale njerëzore në komuna kjo është vështirë e realizueshme.

Nga hulumtimi kualitativ i realizuar vijmë në përfundim se gjeodeti i Drejtorisë së Urbanizmit në hartë i ka të evidentuara të gjitha objektet për të cilat lëshohet leje ndërtimore dhe dihet përafërsisht sa janë realizuar planet. Të gjitha kushtet ndërtimore dhe lejet ndërtimore lëshohen në bazë të rregullativave ligjore në fuqi.

6.1 REKOMANDIMET E STUDIMIT

Zhvillimi i hovshëm i qytetit, i cili ka karakterizuar me mungesë të menaxhimit të mirëfilltë të proceseve, në bazë të planeve rregullative të zonave të caktuara të qytetit, ka ndikuar negativisht dhe ka degraduar ambientin ku jetojmë e veprojmë. Zhvillimet duhen t'i paraprijë një plan i mirëfilltë ku krijimi i vlerës shoqërore është parametri kryesor, e kjo karakterizohet me balanc në mes të zonave të gjelbërta, parqeve, hapësirave publike, dhe sigurisë.

Në bazë të gjetjeve të studimit do të mundohemi që ti bëjmë disa përmbledhje të rekomandimeve për ndërlidhjen në mes qytetit dhe mjedisit dhe si do të mund të ndalet degradimi i mjedisit dhe planifikimi i qëndrueshëm i qytetit.

Nga përgjigjet që kemi marrë nga arkitektët dhe urbanistët, rekomandojmë që duhet të shtohen kontrollet sa i përket respektimit të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës.

Dukuria që është vërejtur nga përgjigjet e pranuar është rritja e kërkesës që tokat bujqësore të kthehen në toka ndërtuese urbane si dhe ka ekspansion të numrit të ndërtimeve në Prishtinë, mirëpo paralelisht me këto është rritur edhe pajisja me leje ndërtimeve si dukuri në rritje.

Edhe pse ka rritje të kërkesës për ndërtime, posedimi i hapësirave të gjelbërta dhe rekreative është një problem i vazhdueshëm, kjo mund të jetë si rrjedhojë e mos kontrollës së drejtorisë së urbanizimit rreth plotësisht të standardeve dhe respektimit të ligjit. Prandaj, rekomandojmë që numri i inspektorëve për kontrollim duhet të rritet. Nga të lartcekurat mund të japim rekomandim që kufijtë e qytetit të Prishtinës të zgjerohen dhe të bëhet lidhja në mes fshatrave dhe kryeqytetit, në brendësi të qytetit të lejohet ndërtimi i objekteve të larta (shumëkatëshe) duke kushtëzuar shtimin e hapësirave gjelbëruese.

Duke e ditur që burimet e ndotjes së ajrit të Prishtinës janë kryesisht trafiku i dendur, djegia e thëngjillit për ngrohje gjatë dimrit, dhe prodhimi i energjisë elektrike, rekomandojmë që të ndërtohen shkolla të reja nëpër zona të caktuara, duke liruar një pjesë të trafikut të qytetit, zgjerimi i sistemit të ngrohjes qendrore të qytetit dhe mundësimi i ngrohjes së ujit sanitar përmes ngrohjes qendrore, ndërtimi i unazave dhe rrugëve që mundësojnë ta evitojnë qendrën e qytetit pa u futur.

1. Të mirren masa për Energji Efiçiente pasi duke ulur kështu problemet me cilësinë e ulët të ajrit si pasojë e ndotjes mbikonsumimi i energjisë elektrike, nga automjetet, mungesës së rrjetit të plotë të ngrohjes etj;
2. Të riparohen ndërtesat publike për të siguruar përdorim të energjisë efiçiente, në objektet e shkollave, qendra shëndetësore, administratë publike, në ndërtesa e ndërtuara nga ish-BVI etj;
3. Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik efiçient si dhe zëvendësimi i ndriçimit aktual me ndriçim efiçient;
4. Të mundësohen grante dhe lehtësime të taksave komunale në rast të blerjeve të veturave hibridi apo elektrike, ndërrimi të dritare, në rast vendosjes së panele solare, fasadën termike apo nëse realizohet projekt tjetër për rritjen e efikasitetit dhe kursimin e energjisë;
5. Të hartohet një masterplani i lëvizjes dhe të promovohet përdorimin i biçikletave dhe mjeteve tjera alternative të transportit, duke krijuar shtigje të veçanta dhe korridore të gjelbërta, të cilat mundësojnë transport më të lehtë, më të lirë dhe më të sigurtë;
6. Të ofrohen me qera biçikleta dhe trotinet elektrik, si dhe të jenë lehtë të çashme;
7. Të krijohet një plan subvencionime dhe lehtësime të taksave për bizneset private duke përfshirë edhe taksitë për t'i shfrytëzuar automjetet elektrike në qytet, si dhe të ndërtohen parkingje në pikat strategjike të qytetit;
8. Të shtohet numri i autobusëve urban dhe ndërrurban, duke përfshirë edhe operatorët privatë, në përputhje me standardet e fundit, me zero përqindje në ndotje të ambientit;
9. Të synohet mbeturina zero, duke përfshirë reduktimin, riciklimin, ripërdorimin e mbeturinave për të prodhuar energji;
10. Të ndërtohen impiante të reja për trajtimin e ujërave të zeza;
11. Të synohet promovimi i përdorimit më efikas i burimeve ujore, duke përfshirë edhe mbledhjen e ujit të shiut dhe duke përdorur riciklimin e ujërave të zeza si dhe mbrojtja e habitateve ujore. Dhe të bëhet menaxhimi i ciklit të ujit që përfshin një infrastrukturë të performancës së lartë për riciklimin e ujërave të zeza (ujrat teknologjike dhe urbane), ruajtja e përdorimi i ujit të shiut;

12. Të krijohen hapsira për absorbim natyral të reshjeve.

Duke edukuar njerëzit të kuptojnë vendin e tyre në natyrë, identitetin kulturor, përgjegjësinë për mjedisin, i ndihmon ata të rrisin aftësinë e tyre për të kontribuar në ruajtjen e ekosistemeve me cilësi të lartë urbane.

- Të ketë përfshirje sa më të madhe të aprovimit të shoqërisë duke shterur në maksimum ankesat dhe zgjidhjen sa më në detale të zgjidhjeve urbane, respektivisht planeve urbane ku fillimisht do të duhej të kemi një plan gjithëpërfshirës si zgjidhje e konceptit të shtrirjes dhe zhvillimit të qytetit duke marrë për bazë në masë të madhe gjendjen faktike dhe mundësit e zhvillimit, respektivisht zgjerimit të qytetit dhe gjithnjë me kriterë urbane sa më moderne;
- Të krijohet një hartë për Eko-qytet duke bërë planifikimin e rajonit ekologjit urban dhe atë rural, për të minimizuar humbjen e tokës rurale dhe për të identifikuar zonat ekologjike të ndjeshme si fushat, bujqësia dhe mjedisi i ndërtuar duhet të rishikohen;
- Në përputhje me Direktivën Europiane për Përformancën Energjetike në Ndërtesa, të krijohet një rregullore për ndërtim, duke përcaktuar kushtet minimale të energjisë eficiente që duhet ti jenë;
- Të ju mundësohen lehtësira bizneseve dhe individëve të cilët ndërtojnë një ndërtesë efiçiente duke bërë projektimin me materialeve termoizoluese dhe marrjen e masave për ruajtje të energjisë;
- Si dhe të bëhet projekti për Fasadat e Gjelbërta në ndërtesat publike me qëllim krijimin e hapësirave të gjelbërta vertikale.

6.2 REKOMANDIME PËR STUDIME TË MËTUTJESHME

Disa temave të mundshme në këtë fushë që mund t'i japin vlerë dhe ndihmesë për studimit do të ishin:

- Kërcënimet klimatike si mungesa e ujit, rrjedhjet urbane, ishulli i nxehtësisë urbane etj;
- Emetimi dhe dekarbonizimi urban i gazeve serrë në qytete;
- Cilësia e dobët e ajrit dhe ekspozimi i popullsisë;
- Rrjetet e transportit dhe ndotja;
- Problemet e furnizimit me ujë;
- Çështjet mjedisore që lidhen me riciklimin;
- Qëndrimet e komunitetit ndaj mjediseve urbane;
- Ujërat e zeza.

7 LITERATURA DHE BURIMET

7.1 LIBRA DHE PUBLIKIME TE PAVARURA

1. Abercombie, N., Hill, S., Turner, B. (1988). Dictionary of Sociology. England, United Kindgom: Penguin books.
2. Anderson, N. (1960). Urban community. A World Perspective. London: Routledge and Kegan Paul.
3. Barber, N. (2009). Summary of estimated water use in the United States in 2005. United States of America: U.S. Department of the Interior.
4. Bairoch, P. (1988). Cities and Economic Development: From the Dawn of History to the Present. Chicago, USA: University of Chicago Press.
5. Brundtland, G. H. (1987). Report of the World Commission on environment and development: Our common future. Oslo: United Nations Press.
6. Cities and climate change: global report on human settlements. (2011). London: UN HABITAT.
7. Cities Transformed: Demographic Change and Its Implications for the Developing World. (2003). Washington, DC: The National Academies Press.
8. Davis, K. (1962). Urbanization in India: Past and Future. India's Urban Future. Okland, California: Berkeley, University of California Press.
9. Ghorra-Gobin, C. (2012). Dictionnaire critique de la mondialisation. Paris: Centre Interdisciplinaire d'études urbaines, Toulouse, Paris.
10. Hauser, P., Duncan, O. (1960). The study of population: An inventory and appraisal. Chicago: The University of Chicago Press.
11. Honjo, M. (1980). Urbanization and Regional Development. United Nations Centre for Regional Development. Nagoya, Japan: Kadokawa Shoten Publishing Co., Ltd.
12. Jänicke, M, et al. (2001). Governance for Sustainable Development in Germany. Institutions and policy-making. Paris: OECD Publications.
13. Kopardekar, H. D. (1986). Social aspects of urbanization. Bombay, India: Notion Press® Publishing.

14. Lampard, E. (1966). Historical aspects of urbanization. England: John Wiley & Sons, Inc.
15. Mayhew, S. (1997). Oxford Dictionary of Geography. Oxford, England: Oxford University Press.
16. Mitchell, J. (1956). Urbanization, detribalization and stabilization in Southern Africa: A problem of definition and measurement. Paris: International African Institute
17. Montgomery, D. (2007). Dirt The erosion of civilizations. Berkeley, California: University of California Press
18. Patacchini, E. et al. (2009). Urban Sprawl in Europe. Switzerland: European Environment Agency.
19. Peterson, M. (1984). Thomas Jefferson: Writings Autobiography. Virginia: Notes on the State of Virginia. New York: New York: Library of America.
20. Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2012-2022. (2013). Prishtinë, Kosovë: Komuna e Prishtinës.
21. Ramachandran, R. (1989). Urbanization and urban systems in India. Delhi: Oxford University press.
22. Rogers, R. (2000). Ciudades para un pequeño planeta. Dominican Republic: Universidad Autonoma de Santo Domingo.
23. Singh, R. (2014). Urban Development Challenges, Risk and Resilience in Asian Mega Cities. Tokyo: Springer Japan.
24. Sovani, N. (1966). Urbanization and urban India. Bombay, Calcutta: Asia Publishing House.
25. Smith, M., Howes, B., Kimball, J. (2007). Preserving and enhancing communities: A guide for citizens, planners, and policymakers. Amherst: University of Massachusetts Press.
26. Tilman, D. (1997). Biodiversity and ecosystem functioning. Nature's services: Societal dependence on natural ecosystems. Washington, D.C: Island Press.

27. Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development. (2015). New York: The United Nation Press.
28. Valuing ecosystem services: Toward better environmental decision-making. National Research Council. (2004). Washington, D.C: The National Academies Press.
29. Van der Ryn, S., Cowan, S. (2007). Ecological design. Washington, D.C: Island Press.
30. Vendbanimet e Kosovës, Tabloja Fizike-Hapësinore, Demografike dhe Funktionale. (2018). Prishtinë, Kosovë: Akadademia e Shkences dhe Arteve e Kosovës.
31. Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2013-2023. (2013). Prishtinë, Kosovë: Komuna e Prishtinës.
32. World Urbanization Prospects: The 2006 Revision. (2007). United Nation, New York: Department of Economic and Social Affairs.
33. World urbanization prospects. The 2014 revision. (2015). New York: United Nations Department of Economic and Social Affairs.
34. Thompson, W. (1935). Urbanization in encyclopedia of social sciences. London: Collier Macmillan Publishers .

7.2 ARTIKUJ DHE REVISTA SHKENCORE

1. Aminrad, Z., Zakaria, S., Hadi, A. S. (2011). Influence of age and level of education on environmental awareness and attitude: Case study on Iranian students in Malaysian Universities. *The Social Sciences*, 6(1), pp. 15–19.
2. Andersson-Sköld, Y, et al. (2015). An integrated method for assessing climate-related risks and adaptation alternatives in urban areas. *Climate Risk Management* 7(2), pp. 31–50.
3. Andreza, V. et al. (2017). Soil and altitude drive diversity and functioning of Brazilian Páramos (campo de altitude). *Journal of Plant Ecology*, 10 (5), pp. 771–779.
4. Bai, X., Shi, P., Liu, Y. (2014). Society: realizing China's urban dream. *Nature*, 509, pp. 158–160.

5. Brenner, N., Schmid, Ch. (2015). Towards a new epistemology of the urban? *City*, 19(2/3), pp. 151–182.
6. Bratman., Hamilton, J., Daily, G. (2012). The impacts of nature experience on human cognitive function and mental health. *Annals of the New York Academy of Sciences*, 1249(1), pp. 118–136.
7. Brenner, N., Schmid, Ch. (2015). Towards a new epistemology of the urban? *City*, 19(2/3), pp. 151–182.
8. Daily, G. (1997). Introduction: What are ecosystem services?. *Journal of Geoscience and Environment Protection*, 3(9), pp. 1–10.
9. Emilsson, T., Sang, Å. O. (2017). Impacts of climate change on Urban Areas and nature-based solutions for adaptation. *Nature-Based Solutions to Climate Change Adaptation in Urban Areas*. *Journal of Springer*, 5(3), pp. 15–27.
10. Ernstson, H. (2013) The social production of ecosystem services: A framework for studying environmental justice and ecological complexity in urbanized landscapes. *Landscape and urban planning*, 109(1), pp.7–17.
11. Furman, A. (1998). A Note on Environmental Concern in a Developing Country: Results From an Istanbul Survey. *Environment and Behavior*, 30(4), pp. 520–534.
12. Gimenez, C., Sierra, V., Rodon, J. (2012). Sustainable operations: Their impact on the triple bottom line. *International Journal of Production Economics*, 140(1), pp. 149–159.
13. Ginsburg, N., Koppel, B., McGee, G. T. (1991). The Extended Metropolis. Settlement Transition in Asia. *The Journal of Asian Studies*, 51(4), pp. 954-956.
14. Goodland, R., Daily, H. (1996). Environmental Sustainability: Universal and Non Negotiable. *Ecological Applications*, 6(4), pp. 1002–1017.
15. Goodland, R. (1995). The Concept of Environmental Sustainability. *Annual Review of Ecology and Systematics*, 26(2), pp. 1–24.
16. Grimm, B et al. (2008). Global change and the ecology of cities. *Science*, 319 (5864), pp. 756-60.
17. Hamman, P. (2017). Definitions and Redefinitions of Urban Sustainability: A Bibliometric Approach. *Urban Environment Journal*, 11(2), pp. 1-27.

18. Harris, N. (1988). Urbanisation: an economic overview of some of the issues. *Habitat International*, 12(3), pp. 103–120.
19. Hoornweg, D., Sugar, L., Trejos Gomez, C. L. (2011). Cities and greenhouse gas emissions: moving forward. *Environment and Urbanization*, 23(1), pp. 207–227.
20. Hoselitz, B. (1955). Generative and Parasitic Cities. *Economic Development and Cultural Change*, 3 (3), pp. 277-302.
21. Humphreys, M. (2005). Natural Resources, Conflict, and Conflict Resolution: Uncovering the Mechanisms. *Journal of Conflict Resolution*, 49(4), pp. 508–537.
22. Işıldar, G. (2008). Evaluation of the effects of environmental education on environmental approaches and behaviors of vocational school students. *Türk Eğitim Bilimleri Dergisi*, 6(4), pp. 759–778.
23. Ives, D et al. (2017). Human-nature connection: A multidisciplinary review. *Current Opinion in Environmental Sustainability*, 4(2). pp. 106–113.
24. Johnson, M. (2001). Environmental impacts of urban sprawl: A survey of the literature and proposed research agenda. *Environment and Planning*, 33(4), pp. 717–735.
25. Kainth, G. (2009). Environmental awareness among school teachers. *The Icfai Journal of Environmental Economics*, 7(1), pp. 34–50.
26. Kasarda, J., Crenshaw, E. (1991). Third world urbanization: Dimensions, theories and determinants. *Annual Review of Sociology*, 17(1), pp. 467–501.
27. Kasman, A., Duman, S. (2015). CO2 emissions, economic growth, energy consumption, trade and urbanization in new EU member and candidate countries: A panel data analysis. *Economic Modelling*, 44(2), pp. 97–103.
28. Li, M, et al. (2012). A new essential protein discovery method based on the integration of protein-protein interaction and gene expression data. *BMC System Biology*, 6(15), p.15.
29. Liu, M, et al. (2018). Reduced resilience as a potential early warning signal of forest mortality. *Nature Climate Change Journal*, 9(11), pp. 1-6
30. Liu, Zh. et. al. (2011). *Drosophila Acyl-CoA Synthetase Long-Chain Family Member 4 Regulates Axonal Transport of Synaptic Vesicles and Is Required*

for Synaptic Development and Transmission. *Journal Neuroscience*, 31(6), pp. 2052–2063.

31. Macura, M. (1961). The influence of the definition of the urban place on the size of the urban population. *Urban research methods. American Journal of Sociology*, 68 (3), pp.21–31.
32. Makinde, O. (2012). Urbanization, housing and environment: Megacities of Africa. *International Journal of Development and Sustainability*, 1(3), pp. 976–993.
33. Matz, C., Stieb., Brion, O. (2015). Urban-rural differences in daily time-activity patterns, occupational activity and housing characteristics. *Environmental Health*, 14(3) p. 88-84.
34. Mason, J. (1989). The Role of Urbanization in National Development: Bridging The Rural-Urban Divide. *Agency for International Development*, 27(2), pp. 1-58.
35. McDonnell, Pickett, 1990, pp. 1232–1236. McDonnell, M., Pickett, S. (1990). Ecosystem structure and function along urban- rural gradients: An unexploited opportunity for ecology. *Ecology Journal*, 71(4), pp. 1232–1236.
36. McCormack, G., Rock., M., Hignell, D. (2010). Characteristics of urban parks associated with park use and physical activity: a review of qualitative research. *Health Place*, 16(4), pp. 712–726.
37. Mitchell, R., Popham, F. (2007). Greenspace, urbanity and health: relationships in England. *Journal Epidemiol Community Health*, 61(8), pp. 681–683.
38. Nechyaba, T., Walshsource, R. (2004). Urban sprawl. *The Journal of Economic Perspectives*, 18(4), pp. 177–200.
39. Newman, P. (2006) The environmental impact of cities. *Environment and Urbanization*, 18(2), pp. 275–295.
40. Pretty, J. et al. (2009). The intersections of biological diversity and cultural diversity: towards integration. *Conservation & Society*, 7(2), pp. 100–112.
41. Smil, V. (1997). China's Environment and Security: Simple Myths and Complex Realities. *SAIS Review (1989-2003)*, 17 (1), pp. 107-126.
42. Srinivasan, S. et al. (2013). Effect of interactions between a child and a robot on the imitation and praxis performance of typically developing children and

one child with autism: a preliminary study. *Perceptual & Motor Skills. Physical Development and Measurement*, 116 (3), pp. 885–904.

43. Tisdale, H. (1942). The process of urbanization. *Social Forces*, 20 (3), pp. 31–316.

44. Vertovec, S. (2007). Super-diversity and its implications. *Ethnic and Racial Studies*, 30(6), pp.1024–1054.

45. Winiwarter, V., Blum, W. (2006). Souls and soils: A survey of worldviews, Footprints in the soil: People and ideas in soil history. *Elsevier Journal*, 36(12), pp.102-122.

46. Zhang, X. (2015). The Trends, Promises and Challenges of Urbanisation in the World. *Habitat International*, 54(4), pp. 241–252.

47. Zhao, Ch, et al. (2017): Temperature increase reduces global yields of major crops in four independent estimates. *Proceedings of the National Academy of Science USA*, 114(35), pp. 9326–9331.

48. Zhou, C., et al. (2015). The relationship between interannual and long-term cloud feedbacks. *Geophysical Research Letters*, 42(23), pp. 10,463–10,46.

7.3 BURIMET ONLINE

1. Conservation Timeline. Conservation Timelines 1901-2000. National Park Services. Woodstock, VT, Conservation Study Institute. 26.02. 2015. URL: <https://www.nps.gov/mabi/learn/historyculture/conservation-timeline-1901-2000.htm>. 02.11. 2022

SHTOJCA 1 : PYETËSORI

I/e nderuar

Fillimisht ju falënderoj për kohën dhe sinqeritetin tuaj në plotësimin e këtij pyetësori.

Koha e cila ju nevojitet ta plotësuar pyetësorin është 10 deri në 15 minuta.

Ky pyetësor realizohet në kuadër të temës së masterit me titull "Interaksioni në mes të Qytetit Dhe Mjedisit"

Ju faleminderit.

Pyetjet Demografike

Sesioni 1

1. Gjinia e juaj:

- a. Femër
- b. Mashkull

2. Moshë e juaj:

- a. 18 - 25 vjeç
- b. 26 - 33 vjeç
- c. 34 - 41 vjeç
- d. 42 - 49 vjeç
- e. Mbi 50 vjeç

3. Niveli i edukimit:

- a. Bachelor
- b. Master
- c. PhD

Sesioni 2

- a. Urbanizmi në Prishtinë bëhet në bazë të:
- b. Zhvillimit të kufizuar
- c. Zhvillimit

| 1. Gjatë projektimit sa i kushton rëndësi: | Aspak | | | | Shumë |
|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| Hapësirës së gjelbër | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Orientimi kah lindja | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Shfrytëzimi i hapësirës | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Dizajni | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Kostos | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

| | | | | | |
|----------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| Ndriçimi | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Izolimi | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

Sesioni 3

Urbanizimi

1 = Nuk pajtohem aspak, 2 = Nuk pajtohem, 3 = Neutral, 4 = Pajtohem, 5 = Pajtohem plotësisht

| Nr. | Pohimet | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|-----|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 1. | Pushteti lokal jep përkrahje të mjaftueshme për zhvillimin urbanistik. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 2. | Kam informata të mjaftueshme lidhur me reformën e kornizës ligjore në planifikimin hapësinor. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 3. | Kam informata të mjaftueshme për planin zhvillimor urban të Prishtinës. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 4. | Kemi kontroll të vazhdueshme nga drejtoria e urbanizmit sa i përket respektimit të Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 5. | Respektoj plotësisht Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 6. | Ka rritje të numrit të popullsisë e cila vjen në zonën urbane të Prishtinës. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 7. | Ka rritje të kërkesës që tokat bujqësore të kthehen në toka ndërtuese urbane | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 8. | Prishtina ka ekspansion të numrit të ndërtimeve. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

Sesioni 4

Ambienti

1 = Nuk pajtohem aspak, 2 = Nuk pajtohem, 3 = Neutral, 4 = Pajtohem, 5 = Pajtohem plotësisht

| Nr. | Pohimet | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|-----|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 1. | Ndërtimet të cilat pajisen me leje janë dukuri në rritje. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 2. | Ndërtimet posedojnë hapësirë të gjelbër dhe rekreative. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 3. | Ndërtimet posedojnë qasje në shërbimet komunale. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 4. | Mbeturinat menaxhohen sipas standardeve evropiane për ndarje dhe riciklim. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

| | | | | | | |
|-----|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 5. | Transporti publik është i shtrirë në tërë territorin e Prishtinës dhe ka linja të rregullta. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 6. | Plani urbanistik është konsistent ndër vite. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 7. | Operatorët ekonomik kanë filtra të vendosur në oxhaqe të ngrohjes, etj. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 8. | Prishtina ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 9. | Pjesa urbane e Prishtinës ka parkingje të mjaftueshme. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 10. | Të gjitha lagjet kanë qasje të lehtë në institucionet komunale. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 11. | Pjesët urbane të Prishtinës kanë ndriçim publik. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

SHTOJCA 2: TË DHËNAT NGA STUDIMI

| Gjatë projektimit sa i kushton rëndësi: | | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
|---|-------------------------------|-----------|---------|---------------|--------------------|
| Hapësirës së gjelbër | Aspak e rëndësishme | 5 | 10.0 | 10.0 | 10.0 |
| | Rëndësi mesatare | 6 | 12.0 | 12.0 | 22.0 |
| | Shume e rëndësishme | 17 | 34.0 | 34.0 | 56.0 |
| | Jashtëzakonisht e rëndësishme | 22 | 44.0 | 44.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Orientimi kah lindja | Aspak e rëndësishme | 3 | 6.0 | 6.0 | 6.0 |
| | Rëndësi e ulët | 2 | 4.0 | 4.0 | 10.0 |
| | Rëndësi mesatare | 18 | 36.0 | 36.0 | 46.0 |
| | Shume e rëndësishme | 24 | 48.0 | 48.0 | 94.0 |
| | Jashtëzakonisht e rëndësishme | 3 | 6.0 | 6.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Shfrytëzimi i hapësirës | Rëndësi mesatare | 3 | 6.0 | 6.0 | 6.0 |
| | Shume e rëndësishme | 16 | 32.0 | 32.0 | 38.0 |

| | | | | | |
|-----------|-------------------------------|----|-------|-------|-------|
| | Jashtëzakonisht e rëndësishme | 31 | 62.0 | 62.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Dizajni | Rëndësi e ulët | 5 | 10.0 | 10.0 | 10.0 |
| | Shume e rëndësishme | 26 | 52.0 | 52.0 | 62.0 |
| | Jashtëzakonisht e rëndësishme | 19 | 38.0 | 38.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Kostos | Rëndësi mesatare | 23 | 46.0 | 46.0 | 46.0 |
| | Shume e rëndësishme | 13 | 26.0 | 26.0 | 72.0 |
| | Jashtëzakonisht e rëndësishme | 14 | 28.0 | 28.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Ndriçimi] | Rëndësi e ulët | 3 | 6.0 | 6.0 | 6.0 |
| | Rëndësi mesatare | 4 | 8.0 | 8.0 | 14.0 |
| | Shume e rëndësishme | 23 | 46.0 | 46.0 | 60.0 |
| | Jashtëzakonisht e rëndësishme | 20 | 40.0 | 40.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Izolimi | Rëndësi e ulët | 2 | 4.0 | 4.0 | 4.0 |
| | Rëndësi mesatare | 11 | 22.0 | 22.0 | 26.0 |
| | Shume e rëndësishme | 9 | 18.0 | 18.0 | 44.0 |
| | Jashtëzakonisht e rëndësishme | 28 | 56.0 | 56.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |

| Pushteti lokal jep përkrahje të mjaftueshme për zhvillimin urbanistik. | | | | | |
|--|--------------------|-----------|---------|---------------|--------------------|
| | | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 14 | 28.0 | 28.0 | 28.0 |
| | Nuk pajtohem | 21 | 42.0 | 42.0 | 70.0 |
| | Neutral | 9 | 18.0 | 18.0 | 88.0 |
| | Pajtohem | 6 | 12.0 | 12.0 | 100.0 |

| | | | | | |
|---|---------------------|----|-------|-------|-------|
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Kam informata të mjaftueshme lidhur me reformën e kornizës ligjore në planifikimin hapësinor. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 2 | 4.0 | 4.0 | 4.0 |
| | Nuk pajtohem | 7 | 14.0 | 14.0 | 18.0 |
| | Neutral | 18 | 36.0 | 36.0 | 54.0 |
| | Pajtohem | 17 | 34.0 | 34.0 | 88.0 |
| | Pajtohem plotësisht | 6 | 12.0 | 12.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Kam informata të mjaftueshme për planin zhvillimor urban të Prishtinës. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 2 | 4.0 | 4.0 | 4.0 |
| | Nuk pajtohem | 5 | 10.0 | 10.0 | 14.0 |
| | Neutral | 9 | 18.0 | 18.0 | 32.0 |
| | Pajtohem | 25 | 50.0 | 50.0 | 82.0 |
| | Pajtohem plotësisht | 9 | 18.0 | 18.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Kemi kontroll të vazhdueshme nga drejtorja e urbanizmit sa i përket respektimit të Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 11 | 22.0 | 22.0 | 22.0 |
| | Nuk pajtohem | 12 | 24.0 | 24.0 | 46.0 |
| | Neutral | 13 | 26.0 | 26.0 | 72.0 |
| | Pajtohem | 8 | 16.0 | 16.0 | 88.0 |
| | Pajtohem plotësisht | 6 | 12.0 | 12.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Respektoj plotësisht Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe planit urbanistik të Prishtinës. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem | 3 | 6.0 | 6.0 | 6.0 |
| | Neutral | 5 | 10.0 | 10.0 | 16.0 |
| | Pajtohem | 18 | 36.0 | 36.0 | 52.0 |
| | Pajtohem plotësisht | 24 | 48.0 | 48.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |

| Ka rritje të numrit të popullsisë e cila vjen në zonën urbane të Prishtinës. | | | | | |
|---|---------------------|----|-------|-------|-------|
| Valid | Neutral | 3 | 6.0 | 6.0 | 6.0 |
| | Pajtohem | 8 | 16.0 | 16.0 | 22.0 |
| | Pajtohem plotësisht | 39 | 78.0 | 78.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Ka rritje të kërkesës që tokat bujqësore të kthehen në toka ndërtuese urbane | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem | 3 | 6.0 | 6.0 | 6.0 |
| | Neutral | 9 | 18.0 | 18.0 | 24.0 |
| | Pajtohem | 15 | 30.0 | 30.0 | 54.0 |
| | Pajtohem plotësisht | 23 | 46.0 | 46.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Prishtina ka ekspansion të numrit të ndërtimeve. | | | | | |
| Valid | Neutral | 8 | 16.0 | 16.0 | 16.0 |
| | Pajtohem | 12 | 24.0 | 24.0 | 40.0 |
| | Pajtohem plotësisht | 30 | 60.0 | 60.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Ndërtimet të cilat pajisen me leje janë dukuri në rritje. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 2 | 4.0 | 4.0 | 4.0 |
| | Neutral | 14 | 28.0 | 28.0 | 32.0 |
| | Pajtohem | 19 | 38.0 | 38.0 | 70.0 |
| | Pajtohem plotësisht | 15 | 30.0 | 30.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |

| Ndërtimet posedojnë hapësirë të gjelbër dhe rekreative. | | | | | |
|--|--------------------|-----------|---------|---------------|--------------------|
| | | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 9 | 18.0 | 18.0 | 18.0 |
| | Nuk pajtohem | 29 | 58.0 | 58.0 | 76.0 |
| | Neutral | 9 | 18.0 | 18.0 | 94.0 |
| | Pajtohem | 3 | 6.0 | 6.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |

| Ndërtimet posedojnë qasje në shërbimet komunale. | | | | | |
|---|--------------------|----|-------|-------|-------|
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 6 | 12.0 | 12.0 | 12.0 |
| | Nuk pajtohem | 13 | 26.0 | 26.0 | 38.0 |
| | Neutral | 17 | 34.0 | 34.0 | 72.0 |
| | Pajtohem | 14 | 28.0 | 28.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Mbeturinat menaxhohen sipas standardeve evropiane për ndarje dhe riciklim. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 22 | 44.0 | 44.0 | 44.0 |
| | Nuk pajtohem | 23 | 46.0 | 46.0 | 90.0 |
| | Neutral | 5 | 10.0 | 10.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Transporti publik është i shtrirë në tërë territorin e Prishtinës dhe ka linja të rregullta. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 3 | 6.0 | 6.0 | 6.0 |
| | Nuk pajtohem | 15 | 30.0 | 30.0 | 36.0 |
| | Neutral | 20 | 40.0 | 40.0 | 76.0 |
| | Pajtohem | 12 | 24.0 | 24.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Plani urbanistik është konsistent ndër vite. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 8 | 16.0 | 16.0 | 16.0 |
| | Nuk pajtohem | 17 | 34.0 | 34.0 | 50.0 |
| | Neutral | 17 | 34.0 | 34.0 | 84.0 |
| | Pajtohem | 8 | 16.0 | 16.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Operatorët ekonomik kanë filtra të vendosur në oxhaqe të ngrohjes, etj. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 3 | 6.0 | 6.0 | 6.0 |
| | Nuk pajtohem | 22 | 44.0 | 44.0 | 50.0 |
| | Neutral | 19 | 38.0 | 38.0 | 88.0 |
| | Pajtohem | 6 | 12.0 | 12.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Prishtina ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza. | | | | | |

| | | | | | |
|--|--------------------|----|-------|-------|-------|
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 12 | 24.0 | 25.5 | 25.5 |
| | Nuk pajtohem | 14 | 28.0 | 29.8 | 55.3 |
| | Neutral | 21 | 42.0 | 44.7 | 100.0 |
| | Total | 47 | 94.0 | 100.0 | |
| Missing | System | 3 | 6.0 | | |
| Total | | 50 | 100.0 | | |
| Pjesa urbane e Prishtinës ka parkingje të mjaftueshme. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 27 | 54.0 | 54.0 | 54.0 |
| | Nuk pajtohem | 14 | 28.0 | 28.0 | 82.0 |
| | Pajtohem | 9 | 18.0 | 18.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Të gjitha lagjet kanë qasje të lehtë në institucionet komunale. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem aspak | 6 | 12.0 | 12.0 | 12.0 |
| | Nuk pajtohem | 19 | 38.0 | 38.0 | 50.0 |
| | Neutral | 14 | 28.0 | 28.0 | 78.0 |
| | Pajtohem | 11 | 22.0 | 22.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |
| Pjesët urbane të Prishtinës kanë ndriçim publik. | | | | | |
| Valid | Nuk pajtohem | 20 | 40.0 | 40.0 | 40.0 |
| | Neutral | 17 | 34.0 | 34.0 | 74.0 |
| | Pajtohem | 13 | 26.0 | 26.0 | 100.0 |
| | Total | 50 | 100.0 | 100.0 | |

